



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR. 11(425)

NENTOR 2023

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI; website: www.VETERANIIOBVL.ORG

79-VJETORI I ÇLIRIMIT



**LANÇ, NJË
NGA FAQET
MË TË
NDRITURANË
HISTORINË E
SHQIPËRISË**

Kolonel SOTIR BUDINA
Kryetar i OBVL

FAQE 3

EVENTIMENT


**OBVL, SESION SHKENCOR PËR ÇETËN
PARTIZANE TË GOLLOBORDËS**



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

FAQE 8

REAGIMI



**CENSUSI –
“BETEJA PËR 20
PËRQINDËSHIN”
NË LIBRIN E ARDIT
BIDOS**

Nga Halil RAMA
Mjeshër i Madh

FAQE 9

KUR ABDURRAHIM BUZA PUTHI NË PUKË FLAMURIN KOMBËTAR SHQIPTAR

EDITORIAL

**KOSOVA DHE
(PA)SIGURIA E
VERIUT**

Nga Bashkim Hisari

Vuçiq, si njeriu më i fuqishëm në Serbi, thotë: “... edhe fëmijët trembëdhjetë vjeçarë janë gati të marrin armët në Kosovë e Metohi”. Pra, nuk është për t'u habitur që më 24 shtator ndodhi sulmi terrorist ndaj Policisë së Kosovës. U vra rreshteri Afrim Bunjaku, dy policë u plagosën, dy të tjerë u lënduan.

VIJON NE FAQEN 5

OPINION

**“IZRAELI, E DREJTA PËR
MBIJETESË DHE
MBROJTJEN E VLERAVE
TË QYTETËRIMIT”!**

Gjeneral © Piro Ahmetaj

Kam ndjekur me vëmendje të shtuar, sigurisht i “shokuar nga pasojat”, por dhe “profesionalisht i zhgënjyer” nga dështimi i Inteligjencës dhe sistemit të mbrojtjes Izraelite, kur në 7 Tetor 2023, Hamasi (i shpallur organizatë terroriste nga ShBA/BE) goditi me breshëri raketa qytetarë të pafajshëm të grumbulluar në festë publike....

FAQE 10

ANALIZA

**PSE ÇËSHTJA ÇAME
NUK EKZISTON PËR
QEVERINË TONË ?**

SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 11



Për vazhdimin e qëndrimit në Pukë, bashkë me Bije Vokshin e Fehmije Buza në ato dy ditë me ngjarje interesante pranë Familjes së mirënjohur NUSHi ia vlen të vazhdohet në një shkrim tjetër

Xhemal Meçi Studiues, “Mjeshër i Madh”

FAQE 13

SUPLEMENTI LETRAT



Nga Kadri Tarelli

**DY VEPRIMTARI
NË NJË DITË**

- Art dhe letërsi

bashkë

Nga OBVL në bashkëpunim me Bibliotekën Publike të qytetit, u përurua libri “VUAJTJAE QYTETIT, Shkodra”, me autor Mark Zadeja, anëtar i Akademisë Evropiane

FAQE 14

80-VJETORI

**BRIGADA E II-TË,
NJËSIA PARTIZANE
QË U KRIJUA DITËN
E PAVARËSISË**

FAQE 2

79-VJETORI

**KUSHTRIMI I
BURRAVE TË
TROPOJËS 79 VJET
MË PARE**

FAQE 4

80-VJETORI

**SI U KRIJUA
ÇETA E DUKAGJINIT
5 NËNTOR 1943**

FAQE 5

PROFILI

**“ZONJA ÇURRE:
S’KEMI Ç’PRESIM MË,
ORE SHOKË!**

Nga Neki ÇAKO

FAQE 12

ESSE

**EDHE PËRRALLAT
PËRSËRITEN**

Nga Merlin Tushe

FAQE 13

80-VJETORI

Brigada e Dytë Sulmuese e nisi veprimtarinë e saj luftarake me përballimin e Operacion armik të Dimrit

BRIGADA e II-të, NJËSIA PARTIZANE QË U KRIJUA DITËN E PAVARËSISË

- *Më 28 nëntor të vitit 1943, ditën e shënuar të përvjetorit të 31 - të të shpalljes së Pavarësisë, u formua Brigada e Dytë Sulmuese, një nga formacionet e para të mëdha të ushtrisë sonë heroike nacionalçlirimtare. Brigada e II-të Sulmuese kishte komandant Beqir Ballukun. Komisar politik ishin Vasil konomi dhe Gani Goxhi*

Krijimi i Br. II S. ishte i lidhur ngushtë me një ngjarje shumë të rëndësishme, për popullin dhe ushtrinë tonë nacionalçlirimtare, me përballimin e Operacionin e madh armik të Dimrit. Efektivi i brigadës së sapoformuar u gjend ballë për ballë me ashpërsinë e dimrit, pa ushqime, municione të pakta dhe veshmbathje si dhe me egërsinë dhe tërbimin e bishës naziste e cila nuk po i zbatonte objektivat e saj, sepse në vendin tonë nuk gjeti një vend e popull të pa organizuar, të hutuar por ai gjeti një popull të organizuar rreth Këshillave nacionalçlirimtare dhe të ushtrisë së tij. Pra brigada e dyte sulmuese e nisi veprimtarinë e saj luftarake me përballimin e Operacion armik të Dimrit.

Ashtu si të gjitha formacionet e njësitë partizane të UNÇSH dhe brigada e dytë sulmuese mori pjesë në përballimin e mësymjes së përgjithshme të armikut në dimrin e vitit 1943-1944 dhe zhvilloi një sërë veprimesh luftarake në zonat e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut.

Ajo përshkoi një rrugë plotë sakrificë e vështirësi me heroizëm. Efektiv i brigadës duke shfrytëzuar me mjeshtëri terrenin e thyer e malor, të zonës së Shëngjergjit - Çermenikë, Martanesh dhe duke zbatuar me mjeshtëri të lartë metodat e taktikës së luftës partizane, në bashkëveprim me forcat territoriale të zone, luftoi me heroizëm dhe i bëri ballë operacionit armik të mbështetur fuqimisht nga forcat e reaksionit shqiptar. Në rrugën e saj luftarake ka kryer një sërë veprimesh luftarake e politike. Ajo zhvilloi veprime luftarake kundër pushtuesit dhe reaksionit në zonat Dibrës, Çermenikës, në rrethinat e Tiranës Priskë, Brar, Pezë, Fushë Krujë, Ishëm dhe Brenda në qytetin e Tiranës. Tipike është veprimi i mbrëmjes së 17 Janarit 1944, kur njësitë partizanë rreth 20 vetë të drejtuar nga Heroi i Popullit Kozma Naska, në ora 01:00, goditi garnizonin armik në shkollën e Kuqe në bashkëveprim me njësitin gueril të qytetit, duke i shkakuar armikut humbje të mëdha në forca rreth 25 të vrarë dhe shumë të plagosur. Ky aksion beri bujë të madhe në Tiranë ngriti moralin e partizanëve dhe besimin në popullin e qytetit se vetëm partizanë mundë ta çlironin vendit nga pushtuesit dhe bashkëpunëtorët e tyre. Opera-



cioni armik i dimrit, si për të gjitha formacionet partizane edhe për efektivin e Brigadës së Dytë Sulmuese, ishte një sprovë e madhe, e rëndë dhe e vështirë, me gjithë mangësitë e drejtimit nga shtabi i Brigadës, si rrjedhojë e ndërhyrjes nga Shtabi i Përgjithshëm u kalua me sukses.

Brigada kaloi me vështirësi pengesa të ndryshme, të diktuar nga sulmet e forcave naziste dhe bashkëpunëtorëve të tyre dhe kushtet e këqija atmosferike të dimrit shumë të ashpër të atij viti, për të evituar asgjësimin ajo u shpërnda në formacione të vogla duke manovruar nëpër Martanesh - Çermenikë, i doli në shpinë forcave gjermano - balliste. Në prill 1944 më urdhër të SHP, kaloi lumin Shkumbin dhe u nis për në zonën e Panaritit. Gjatë rrugë kalimit për në Panarit ajo spastroi forcat reaksionare të ballit në Dumre dhe

arriti në Panarit. Me të mbërritur në Panarit ajo beri riorganizimin, duke u kompletuar me forca të reja nga qarku i Korçës duke e dyfishuar efektivin e saj me partizan të rinj.

Të cilët i dhanë gjallëri brigadës. Fillimi i operacionit armik të Qershorit 1944 e gjeti brigadën në rrugë të punimeve të Kongresit të Parë Antifashist të Përmetit. Në kuadrin e detyrave, që u caktoi Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH -së të gjitha formacioneve partizane, për të përballuar operacionin armik të Qershorit, efektivit të brigadës ju ngarkua të vepronte për të mbyllur drejtimin Leskovik - Përmet me një batalion, ndërsa me forcat kryesore do të vepronte në zonën Frashër - Dangëlli duke mbrojtur këtë drejtim për të mos lejuar afrimin e forcave gjermane dhe balliste, detyrë që brigade e kreu me sukses. Pas dështimit të Operacionit armik të Qershorit, i cili u përballua me shumë sukses nga formacionet partizane të UNÇSH -së, Brigada e Dytë Sulmuese mori detyrë të vepronte në qarkun e Korçës me detyrë në bashkëveprim me Br IX S dhe forcat partizane që vepronin në këtë qark të çlironte qytete Korçën, Leskovikun, Ersekën, Bilishtin. Brigada kreu një sërë veprimesh luftarake në zonën e Korçës.

Brigada për disa muaj me radhë, në bashkëveprimi me njësitet territoriale të fshatarëve zhvilloi luftime të shumta si në Qafën e Qarrit, Devoll, Bozhigrad (sot Mirasi), Vithkuq, në fushën e Korçës, në Pojan dhe në Zëmlak. Një nga luftimet më të suksesshme i Brigadës ishte ai i 17 shtatorit 1944 në afërsi të fshatit Dëshnicë të Korçës, që në bashkëveprim me Batalionin "Skënder Çaçi" sulmoi forcat gjermane dhe balliste që ishin të garnizonit të Korçës.

Veprimet ishin të shpejta, të befasishme dhe të fuqishme duke i detyruar forcat gjermane të tërhiqeshin në panik. Ndërkohë Brigada gjatë muajit shtator - tetor 1944 ndërmoi sulme të fuqishme dhe çlirojë Leskovikun, Ersekën dhe më pas Bilishtin. Me çlirimin e këtyre qyteteve, ajo mori



79-VJETORI I ÇLIRIMIT

Aleatët e Mëdhenj: Anglia, Bashkimi Sovjetik e SHBA që shkatërruan bishën nazifashiste e u siguruan popujve lirinë

LANÇ, NJË NGA FAQET MË TË NDRITURA NË HISTORINË E SHQIPËRISË

• Populli ynë, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e kudo në trojet etnike është krenar se iu bashkua në Luftë Aleancës së Madhe Antifashiste të Popujve. E çliruam Shqipërinë pa ndërhyrjen direkte të forcave aleate por edhe dhamë kontribut të çmuar në këtë Luftë

• Ne shprehim falenderimet tona për ndhmën që dhanë Aleatët e Mëdhenj: Anglia, Bashkimi Sovjetik e SHBA që shkatërruan bishën nazifashiste e u siguruan popujve lirinë



Kolonel SOTIR BUDINA
Kryetar i OBVL

Në shqiptarët kemi të drejtë të krenohemi për Luftën e lavdishme, Antifashiste Nacionalçlirimtare që çoi në çlirimin e vendit nga okupatorët nazifashistë. Ne krenohemi sepse me luftën e sakrificat mbinjerëzore, dhe gjakun e dhjetra mijëra dëshmorëve u bëmë pjesë e bllokut antifashist të popujve të botës, të kryesuar nga aleanca anglo-sovje-to-amerikane. Në momentin historik populli shqiptar, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e kudo që jetonte në trojet e tij etnike u bashkua me forcat e lirisë kundër atyre të errësirës. Në bazë të kësaj lufte e sakrificave që bëmë, ne siguroam jo vetëm pavarësinë e Shqipërisë por të drejtën e shqiptarëve në Kosovë për vetëvendosje e të shqiptarëve kudo që jetojnë, të drejtën për të qëndruar në trojet e tyre etnike. Kjo ishte fitorja e dytë më e madhe në historinë tonë kombëtare, pas shpalljes së pavarësisë dhe ngritjes së Flamurit në Vlorë.

Në Luftën e Dytë Botërore gjithë populli shqiptar ishte në rrezik. Shqipëria mund të humbiste pavarësinë. Populli shqiptar i Kosovës e ai i shqiptarëve të tjerë në trojet e tyre etnike mund të shpënguleshin nga trojet e tyre e të pësonin fatin e atyre shqiptarëve që u dëbuan me forcën e armëve nga serbët në vitet 1870-1880 nga zonat e Nishit, Vranjës, Prokupjes, Leskocit etj dhe të popullit çam. Ky rrezik vinte sepse pushtuesit italianë erdhën me parullën e bashkimit të shqiptarëve nën kurorën e Viktor Emanuelit; krijuan qeverinë kuislinge për ti dhënë pamjen e një shteti të pavarur dhe me shkatërrimin e Jugosllavisë dolën me parullën e Shqipërisë së Madhe. Në këtë mënyrë u përpoqën ta lidhin popullin tonë me bllokun fashist. Të njejtën rrugë ndoqi edhe Gjermania Naziste pas kapitullimit të Italisë duke mbledhur një Asamble Tradhtare që e shpalli Shqipërinë të Pavarur, pasi gjermanët kishin deklaruar se “ne jemi kalimtarë dhe Shqipëria do të jetë e pavarur!”. Vetëkuptohet, pavarësi me nazistët brenda në Shqipëri! Me këto parulla ata u përpoqën ta joshnin popullin shqiptar, ta mbanin të lidhur me ta dhe me ndihmën e kuislingëve bashkëpunëtorë të tyre

ta vinin në interes të tyre kundër Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Po të mos kishte filluar e zhvillohej Lufta Nacionalçlirimtare, kombi shqiptar do të kishte shkuar në humnerë bashkë me nazifashistët dhe do të ishin plotësuar lakmitë grabitqare sllavo-greke për copëtimin edhe të shtetit shqiptar, për të cilat punonin edhe qeveritë mbretërore greko-serbe në egzil.

LUFTA ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE PËRFSHIU GJITHË SHQIPËRINË

Ishte zhvillimi i Luftës Nacionalçlirimtare që përfshiu gjithë Shqipërinë dhe që vetëm brenda vitit 1942 ishin krijuar 22 çeta partizane nga Konispoli në Jug deri në Malësinë e Gjakovës në Veri, jehona e kësaj lufte bëri që ministrat e jashtëm të Anglisë-Iden, i Bashkimit Sovjetik, Mollotov dhe i SHBA-Hell, në

nalçlirimtare. Pas kësaj bindje ata i shtuan misionet e tyre në Shqipëri dhe filluan të na ndihmojnë me armatime e materiale luftarake, megjithëse shumë të kufizuara për shtimin e zgjerimine Ushtrisë sonë gjatë viteve 1943-1944. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e ushtrive aleate bënë të gjitha përpjekjet për ti bashkuar e futur në luftë forcat nacionaliste të Ballit Kombëtar e Legalitetit, por nuk patën sukses.

LANÇ, LUFTA E SAKRIFICAVE TË MËDHA

Ushtria Nacionalçlirimtare pasi theu me sukses Operacionin më të Madh të Forcave Naziste e bashkëpunëtorëve të tyre në dimrin e egër të viteve 1943-1944 e kish çliruar hapësira të mëdha të vendit, krijoji kushte për mbajtjen e Kongresit Antifashist në qytetin e çliruar të Përmetit. Nga ky Kongres doli komiteti An-



Dhjetor 1942 të bënin deklaratën “që dëshëronin ta shihnin Shqipërinë të çliruar nga zgjedha italiane dhe të vendoset pavarësia e saj. Forma e regjimit dhe e qeverisë që do të vendoset në Shqipëri do të jetë një çështje që do ta vendosë vetë populli shqiptar në fund të luftës”. Megjithatë në këtë deklaratë qeveria angleze mbante një rezervë kur shprehej se “e sheh çështjen e kufijve shqiptarë pas Luftës si një çështje që duhet të merret në shqyrtim në Konferencën e Paqes”. Kjo deklaratë ishte mbështetje për qeveritë greko-jugosllave në egzil që përgatisnin plane për copëtimin e Shqipërisë. Por Lufta Nacionalçlirimtare kishte marrë zhvillime të vrullshme që me krijimin e reparteve sulmuese të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm me 10 Korrik 1943. Ky shtab mori në drejtimin dhe centralizoi veprimet luftarake duke u shtuar goditjet kundër pushtuesve u krijuan zona të lira. Në këto momente aleatët e në radhë të parë anglezët dërguan përfaqësuesit e tyre pranë Shtabit të Përgjithshëm të cilët ndiqnin nga afër Luftën tonë dhe u bindën se e vetmja forcë ushtarake e organizuar në Shqipëri që bënte Luftë të vendosur kundër pushtuesve nazifashistë ishte Ushtria Nacio-

tifashist me atributet e një qeverie provizore. Pas Kongresit u bënë ndryshime në organizimin e Ushtrisë. Ajo kaloi nga formacionet e Brigadave në ato të Njësisë të Mëdha të Divizioneve e Koparmatave, të afta për të kryer operacione operative strategjike në të gjitha hapësirat e vendit. Me thyerjen e operacionit gjerman të Qershorit '44, i fundit i ndërmarrë nga nazistët në vendin tonë, në korrik 1944 forcat e Divizionit të Parë kaluan në mësymje për çlirimin e Shqipërisë së Mesme e të Veriut, dhe me çlirimin e Matit, të Dibrës e të Lumës, Brigada e Pestë u shkëput nga varësia e Divizionit të Parë dhe së bashku me Brigadën e Tretë morën urdhër të kalojnë në Kosovë për të ndihmuar në çlirimin e saj. Detyra kryesore që u ngarkonte Shtabi i Përgjithshëm ishte që në bashkëveprim të ngushtë me forcat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Kosovës të godisnin pa ndërprerje forcat naziste e të shpejtonim çlirimin e Kosovës; të ndihmonin që rinia kosovare të merrte pjesë masive në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, me qëllim që Kosova të bëhej pjestare e aleancës antifashiste të popujve që luftonin kundër

HISTORIA

Nga radhët e Brigadës së 25-të Sulmuese, brenda dhe jashtë vendit, ranë për liri 53 partizanë

79-VJETORI - Brigada e 25-të Sulmuese, kushtrimi i burrave të Tropojës 79 vjet më parë

Krijimi i Brigadës 25 Sulmuese Partizane shënoi kulmin e pjesëmarrjes së popullit të Tropojës në LANÇ, i cili e kishte përfaqëuar Luftën Antifashiste qysh në fillim dhe ishte ndër të parët që kishte krijuar çetën partizane. Veteranët tropojanë ndjehen krenarë, që ishin në ballë të rezistencës antifashiste në Frontin ANÇ. Kalimi i Divizionit I S në Shqipërinë e Mesme e të Veriut ishte një veprim shumë i rëndësishëm i Komandës së Përgjithshme. Ai veprim i dha të tjera dimensione kryengritjes së përgjithshme të armatosur, duke rritur në një shkallë më të lartë forcën goditëse të UNÇSH kundër nazistëve dhe tradhëtarëve të vendit që bashkëpunonin ngushtësisht me hitlerianët.

Ky veprim i dha zjarr e kurajo popullit të krahinave veriore dhe ndikoi fuqishëm në çlirimin e rrethëve të veriut e të krejt vendit, pasi sipas urdhrat të Komandës së Përgjithshme të UNÇSH, më 25 tetor 1944, pas çlirimit të Tropojës, më 16 tetor, u krijuan kushte për krijimin e një njësie të re të madhe partizane, Brigadës 25-të S. Brigada 25-të S u krijua, në Astë-Tropojë, më 6 nëntor 1944. Ishin 900 partizanë, 700 nga Tropoja 200 nga Hasi, që vinin nga batalionet "Bajram Curri", "Rinia", "Territorial" dhe vullnetarë nga Malësia e Gjakovës e Hasit, që i mblodhi ai shesh në Ast. Nga ai shesh ku ngrihet sot lapidari e ku u mblodhën bashkë partizanë të Tropojës, Malësisë së Gjakovës e Hasit dhe bashkuan zemrat e pushkët, për një ideal të vetëm të përbashkët lirinë e pavarësinë e Atdheut, do të mbetet gjithmonë një monument historik. Komandant i Brigadës XXV u caktua Veli Doçi, zv/komandant Çelo Arrëza- komisar Nuri Arapi, zv/komisar Spiro Pano, përgjegjës rinie Jovan Antoni, itendent Maxhun Nimani.

Në 4 batalionet u caktuan këta komandantë: batalioni i komandant Idriz Mulosmani, batalioni II komandant Ali Brahimi, batalioni III komandant Mehmet Mulosmani dhe batalioni IV komandant Ismail Poga. Brigada e 25-të S e pati jetën të shkurtër, vetëm 23 ditë në Luftë, deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë, por kontributi i saj ishte i madh.

Ato 23 ditë u kthyen në ditë sulmi e betejash të përgjakshme, në ditë fitoresh e gëzimesh, sepse ajo mori pjesë në çlirimin e disa qyteteve e krahinave, brenda vendit e jashtë kufijve zyrtarë, në territore shqiptare e të ish- Jugosllavisë, ku përjetoi gëzimin e lumturinë e popullit për lirinë e fituar. Që ditën e parë të formimit nisën aksionet e kundër pushtuesve nazistë e bashkëpunëtorëve të tyre reaksionarë e tradhëtarë të popullit.

Batalioni I dhe II u nisën në drejtim të Plavës dhe Gucisë për çlirimin e tyre dhe, më pas, do të marshonin drejt Pejës. Kështu veprimet e para kjo brigadë i zhvilloi në Plavë e Guci dhe më 18 nëntor do të bëhej pjesë e Divizionit të Pestë Sulmues.



Udhëtimi drejt Sanxhakut e Bosnjes...

Brigada e 25-të Sulmuese në bashkëveprim me Brigadën e 6-të, nga 21 deri me 25 nëntor 1944



zhvillon luftime kundër forcave gjermane dhe atyre reaksionare të përqendruara në Nikaj Mërtur dhe Dukagjin. Pasi spastroi këtë krahinë nga armiku, më 28 nëntor 1944, çliruan qytetin e Gjakovës dhe bashkë popull e partizanë festuan festën e madhe të pavarësisë.

Në luftë e sipër efektiv i saj rritet. Në efektivin e ri u shtuan rreth 550 partizanç, nga këto 200 ishin hasianë dhe 350 kosovarë. Pra, për disa ditë efektiv i kësaj brigade gati u dyfishua. Në datat 28 e 30 nëntor brigada bëri 80 km rrugë nga Gjakova në Ferizaj dhe ndihmoi brigadën e 2-të Jugosllave të Kosmetit, që ishte rrethuar nga gjermanët, të dilte nga rrethimi.

Pasi e çliruan qytetin e Ferizajt, së bashku me brigadat e tjera të Divizionit të 5-të, marrshuan drejt Sanxhakut e Bosnjes. Më 3 dhjetor 1944 brigada shkoi në Ferizaj, dhe u gjend përballë një mynxyre.

Një natë më parë serbët kishin vranë 360 veta të pafajshëm, 50 prej tyre në xhaminë e qytetit. Ishte një masakër e tmerrshme. Brigada e 25 Sulmuese zëvendësoi Brigadën e 3-të në luftimet në krahinën e Priepoljes dhe së bashku me Brigadën e 5-të e çliruan atë.

Kjo brigadë i kreu me nder detyrat e saj duke dhënë, kontributin e saj në LANÇ, kontribut edhe në çlirimin e Kosovës. Djemtë e saj derdhën gjakun për liri.

Luftuan jashtë trojeve zyrtare të vendit tonë, në tokat shqiptare dhe ato jugosllave dhe dhanë shembull të shkëlqyer internacionaliste.

Nga radhët e Brigadës së 25-të Sulmuese, brenda dhe jashtë vendit, ranë për liri 53 partizanë. Armiku dogji fshatrat e Bytyç, Pac, Vlad, Zharkë, Lonicë, Correj, Viliq, Kam, Kepenek, Zogaj ku u vranë edhe 35 burra të kësaj krahine. Veteranët e populli i Tropojës çdo vit mblidhen aty, përpara lapidarit që i kushtohet kësaj brigade dhe kujtojnë shokët partizanë, që nuk jetojnë më, kujtojnë atë kohë të lavdishme kur luftohej për liri.

BRIGADA e II-të, NJËSIA PARTIZANE QË U KRIJUA DITËN E PAVARËSISË

(Vijon nga faqja 2)

për detyrë që, në bashkëveprim me Br IX S dhe një batalion të Br XX S, të sulmonte e të çlironte qytetin e Korçës. Luftimet për çlirimin e Korçës vazhduan për disa dite e net dhe, më 24 tetor Korça u çlirua. Me çlirimin e Korçës ajo mori për detyrë që të mbante nën goditje forcat gjermane që tërhiqeshin në rrugë kalimin Strugë - Qafë Thanë- Prrenjas - Librazhd. Ajo bëri shumë aksione sulmuese për gjatë këtij rrugëkalimi dhe i shkaktoi forcave gjermane dëme në forca dhe mjete. Në të gjitha veprimet luftarake dhe aksionet, ajo bashkëpunoi

dhe i koordinoi veprimet me forcat territorial të zonës, popullin dhe këshillat nacionalçlirimtare të fshatrave ku kryheshin luftimet. Brigada 2-të Sulmuese i kreu të gjitha detyrat që iu ngarkuan nga SHP dhe KP e UNÇSH dhe këtë ë tregojnë shifrat e më poshtme, nga radhët e Brigadës ranë në fushën e betejës 40 dëshmorë, e shumë të plagosur, që ranë në fushën e betejës për të mos vdekur kurrë si "Heroi i Popullit" Kozma Naska, Besim Imami, Shejnaze Juka, Raqi Themeli, Neshat Kondi, Jaçe Hormova. Nazmi Gaba etj.

Lavdi Heronjve dhe Dëshmorëve të Brigadës së II-të S.

80-VJETORI

Populli i Dukagjinit ka ditur të dallojë kush ishte në favor të tyre e kush jo, prandaj e ndihmoi me gjak e shpirt luftën për liri

Si u krijua Çeta e Dukagjinit 5 nëntor 1943

Krijimi i batalionit "Perlat Rexhepi" më 30 korrik 1943 dhe i çetave e batalioneve të tjera partizane e rritën besimin në popull se dita e fitores ishte afër. Ky besim e optimizëm ndihej edhe në Dukagjin ku diskutohej vazhdimisht të formohej një njësi partizane. Që në korrik 1943 nga qarkori i Shkodrës u bënë përpjekje të shumta për krijimin e një çete partizane në Dukagjin. Detyrat që shtroheshin për çlirimin e vendit, ndiheshin fuqimisht edhe në Dukagjin. Bazat teorike e praktike të krijimit të saj, ishin përgatitja e popullit për luftë, pa dallim feje, besimi e krahine, si dhe organizimi i kryengritjes së përgjithshme të armatosur për çlirimin e vendit. Pavarësisht përpjekjeve të bëra që në korrik 1943, u desh të kalonin edhe disa muaj që detyra të bëhej realitet. Kjo u arrit me 5 nëntor 1943 kur në një fshat të zonës së Shoshit, u arrit të krijohet çeta partizane e Dukagjinit. Në kushte të rrethana të tilla bënë që qarku i Shkodrës të dërgonte edhe një herë një grup shokësh si; profesor Kol



Prela, Qazim Kapisyzi, Sadik Bekteshi, Tom Kola "Hero i Popullit". Me krijimin e çetës, 36 luftëtarë të udhëhequr nga trimi Gjon Marashi, komisar Markket Pjetri Dëshmor i Atdheut, detyrat

kryesore ishin kundërvënia e propagandës antifashiste, shtimi me elementë të rinj të çetës së sapokrijuar, dhe mundësia e kompletimit të batalionit "Perlat Rexhepi", dhe e njësisive të

UNÇSh që vepronin në këtë zonë, me djem të rinj nga Dukagjini. Çeta e parë e Dukagjinit, kreu edhe mjaft aksione luftarake, kundër armiqve. Nga këto aksione dhe puna propagandistike me popullin, çeta e Dukagjinit, po krijonte përditë e më shumë terren. Por duhet të pohojmë dhe jo ta "fshehim" e ta shtrembërojmë këtë fakt, siç bëjnë sot pinjollët e Ballit dhe armiqtë e LAN? E vërteta është se çeta partizane e Dukagjinit, u përball me mjaft vështirësi nga bajraktarët e kleri katolik. Të thuash të kundërtën, do të thotë të shtrembërosh historinë. Kleri e bajraktarë ata u bashkuan me fashizmin e nazizmin dhe luftonin që të mos humbisnin interesat dhe influencën e tyre. Prandaj, ndodhi që ata që ju kundërvunë partizanëve të çetës dhe jo vetëm; me të gjitha mjetet, por nuk mundën të ndalnin idealin e partizanëve për çlirimin e vendit. Populli i Dukagjinit ka ditur të dallojë kush ishte në favor të tyre e kush jo, prandaj e ndihmoi me gjak e shpirt luftën për liri.

LANÇ, NJË NGA FAQET MË TË NDRITURA NË HISTORINË E SHQIPËRISË

(Vijon nga faja 3)

nazistëve dhe në këtë mënyrë të fitonte të drejtën për vetëvendosje; të ndihmonim për ngritjen e Këshillave Nacionalçlirimtare në zonat e çliruara. Për realizimin e këtyre detyrave e drejtimin e veprimeve lufarake u krijua Shtabi i përbashkët Operativ i dy Brigadave dhe Forcave të Kosovës, i përbërë nga Fadil Hoxha-komandant i Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Kosovës, Shefqet Peçi – komandant i Brigadës së Pestë dhe Hulusi Spahi-Komandant i Brigadës së Tretë. Megjithë rezistencën e ashpër të forcave naziste e të mbeturinave të Divizionit ESS Skënderbeg për të mbajtur qytetet Prizren, Gjakovë e Pejë e për të siguruar tërheqjen e shpejtë e të organizuar të reparteve naziste për në Frontin Perëndimor kundër forcave aleate, forcat tona i mundën e i shpartalluan nazistët me luftime shumë të ashpra që u zhvilluan në Gjakovë e sidomos në Junik e Deçan. Në këto luftime Brigada e Tretë ka pas humbjet më të rënda në historinë e saj luftarake; 32 të vrarë e shumë të plagosur. Edhe armiku pati humbje të rënda-shumë të vrarë e të plagosur; u zunë rreth 30 rob nga forcat e Divizionit Skënderbeg pasi kishin nxjerrë nga rrethimi komandanët e tyre nëpërmjet një çepengu. Mes tyre kishin qenë Rexhep Deva, Demali Pozhari, një oficer gjerman e të tjerë. Partizanët tanë, të zemëruar nga humbjet e shokëve të tyre kërkonin me këmbëngulje

pushkatimin e robërve. Me shumë vështirësi u bindën ti lirojmë, pasi ne nuk kishim shkuar në Kosovë për të vrarë vëllezërit tanë po për çlirimin e tyre. Atyre iu morën armët e u liruuan duke i porositur të mos shkolin prapë në shërbim të armikut e të vriteshin vëlla me vëlla siç ndodhi në ato luftime. Duhet ta pohojmë se prej asaj dite, pushkë kosovari nuk qëlloi më kundër forcave tona partizane. Luftimet për çlirimin e Deçanit, Pejës e gjithë Rrafshit të Dukagjinit përfunduan me 17 nëntor 1944.

Gjeneral Rrahman Parillaku, në librin e tij me kujtime, shkruan se "Na vjen keq kur dëgjojmë a shkruhet në ndonjë gazetë se forcat tona kanë vrarë njerëz të pafajshëm në Kosovë. Unë pohoj se kjo nuk ka ndodhur në asnjë rast, përveç kur jemi ndodhur ballë për ballë në luftime. Nuk e di a jeton ndonjë nga të liruarit të jetë dëshmitar i kësaj. Lufta e Brigadave tona për çlirimin e krahinave të Kosovës dha ndihmesë për pjesëmarrjen e djemve të saj në Luftë. Pjesëmarrja masive në Luftën Nacionalçlirimtare e popullit të Kosovës nën drejtimin e Fadil Hoxhës e shokëve të tij ka qenë vendimtare. Ajo bëri të dështojnë planet e Çubrolloviçit që i kishte servirur komandës së Ushtrisë Jugosllave për spartimin etnik të shqiptarëve nga trojet e tyre. Arkitekt i mendimit shovinist serb Vasaçubrolloviçi me elaboratorin e tij të dytë të vitit 1944 jepte direktivën politike se paskësh ardh momenti i përshtatshëm për ti larë hesapet me shqiptarët njëherë e përgjithmonë; e për ti dëbuar nga trojet e tyre..... Asnjëherë ne nuk kemi pasur kushte më të favorshme". "Luftrat,-vazhdon më tej ai, janë momenti më i përshtatshëm për zgjidhjen e këtyre problemeve". Ai shpreh bindjen se "aleatët tanë do të na kuptojnë dhe do të plotësojnë dëshirat tona, veçanërisht një shpresë të madhe kemi tek Bashkimi Sovjetik vëlla". Dhe në fund ideologu shovinist serb jepte direktivën për ushtrinë: "Ushtria gjatë operacioneve luftarake duhet të spastrojë në mënyrë të planifikuar e pa mëshirë pakicat kombëtare shqiptare".

Edhe Konferenca e Tre të Mëdhenjve (Çurçill-Stalin-Rustevlt)

u jepte të drejtë shteteve fituese në luftë për shpërnguljen e pakicave kombëtare që ishin bashkuar me bllokun fashist. Shembull konkret ishin Rumania që iu shkëput një republikë e tërë, Moldavia nga trojet e veta, pa llogaritur shpërnguljen e më se dhjetë milionë gjermanëve nga Prusia, Krakovia, etj.... Platforma politike dhe ushtarake e Çubrolloviçit, e mbajtur sekret nga Beogradi për çështjen e Kosovës u dogj nga 55 mijë djemtë e saj që morën pjesë në Luftë dhe mijëra dëshmorëve kosovarë që dhanë jetën duke luftuar përkrah forcave antifashiste të botës. Lufta e Brigadave tona për çlirimin e krahinave të Kosovës dha ndihmesë për pjesëmarrjen e djemve të saj në Luftë. Me largimin e Brigadave tona nga Kosova, në drejtim të Sanxhakut e Bosnjës, forcat serbo-sllave përfshi dhe ato çetnike u përpoqën të vënë në zbatim planin e Çubrolloviçit, por ishte vonë.

Forcat shqiptare ishin të armatosura; ata bënë qëndresë të fortë duke luftuar për jetë a vdekje nën komandën e Shaban Palluzhës. Krimet qenë të rënda, por planet e Çubrolloviçit nuk u realizuan. Shqiptarët mbetën përjetë në trojet e tyre etnike. Forcat e dy Divizioneve tona e vazhduan luftën në tokat e Jugosllavisë, duke dhënë ndihmesën e tyre, jo vetëm në çlirimin e krahinave të Malit të Zi, Sanxhakut e Bosnjës por edhe duke penguar, dëmtuar e vonuar forcat naziste që përpiqeshin të tërhiqeshin me shpejtësi e në mënyrë të organizuar për në Frontin e Perëndimit, për të luftuar kundër forcave aleate që kishin zbarkuar në Francë. Luftimet e forcave tona në këto vende janë zhvilluar në kushte tepër të vështira, të një dimri që u kujtonte atë të dimrit '43-'44 në Shqipëri, me mungesë të theksuar në ushqime e mjete të tjera të jetesës. Por ata e kryen me nder detyrën.

Dua të kujtoj se në këto luftime kanë rënë afër 600 dëshmorë të dy divizioneve tona. Ky ishte edhe një kontribut i veçantë në Luftën Antifashiste. Populli ynë, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e kudo në trojet etnike është krenar se iu bashkua në Luftë Aleancës së Madhe Antifashiste të Popujve; E çliruam Shqipërinë pa ndërhyrjen direkte të forcave aleate por edhe dhamë kontribut të çmuar në këtë Luftë. Patjetër, ne shprehim falenderimet tona për ndihmën që dhanë Aleatët e Mëdhenj: Anglia, Bashkimi Sovjetik e SHBA që shkatërruan bishën nazifashiste e u siguruan popujve lirinë.

Lavdi dëshmorëve të Kombit tonë të të gjitha Luftërave çlirimtare.



AKTUALITET

Pesë ndërmjetësit e dialogut në Kosovë e Serbi me një plan! Dy kushtet e prera: Kurti e Vuçiç t'i përmbahen detyrimeve! E papranueshme çdo vonesë

SHBA e BE në një zë: Kosova e Serbia t'i kthehen dialogut!

Pesë ndërmjetësit e dialogut ishin në Prishtinë dhe Beograd me një plan konkret të cilin ia kanë propozuar kryeministrit të Kosovës dhe presidentit serb. Të dërguarit e SHBA-së, BE-së, Gjermanisë, Italisë dhe Francës theksuan se normalizimi i situatës është më urgjente se kurrë. Kurti i kërkuan formimin e asociacionit të komunave serbe, ndërsa Vuçiç të dënojë autorët e sulmit të 24 shtatorit.

PRISHTINE - BEOGRAD - Pesë diplomatë, të dërguarit e SHBA-së, BE-së, Gjermanisë, Italisë dhe Francës udhëtuan të shtunën më 21 tetor 2023 drejt Prishtinës dhe Beogradit me qëllim ringjalljen e dialogut. Ata thanë se kishin shkuar me një plan konkret të cilin ia kishin propozuar kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit serb Aleksandër Vuçiç.

Në një postim në tëtter i dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë-Serbi, Miroslav Lajčák tregoi dhe kushtet e prera që emisarët i kishin përcjellë dy liderëve. "Ne theksuam se sulmi i 24 shtatorit në veri të Kosovës duhet të hetohet plotësisht dhe se de-përshkallëzimi dhe normalizimi i situatës janë urgjentisht të nevojshëm. Ne presim që të dy të përmbushin plotësisht detyrimet e tyre të Dialogut" shkruan Lajčák në një postim në rrjetin social X.



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani në Këshillin e Sigurimit të OKB-së:

Kosova ka zgjedhur dialogun në tavolinë të udhëhequr nga delegacioni i BE-së

"Kosova ka zgjedhur dialogun në tavolinë të udhëhequr nga delegacioni i BE-së, në një rën anë e kemi kryeministrit të Kosovës, një të burgosur politik dhe në anën tjetër presidentin e Serbisë, që e kishte torturuar atë kur ishte pjesë e regjimit të Millosheviqit. Nuk do të heqim dorë kurrë nga dialogu si mënyra e vetme për të zgjidhur dallimet ndërmjet nesh sepse Kosova është vend plotë me Mandela, Ganda dhe Martin Luther King. Njerëz që luftojnë për të ardhmen, paqen dhe pajtimin"



'ERDHËM ME NJË PLAN'...

Misioni i të besuarve të 5 shteteve të mëdha nisi paraditen e 21 tetorit 2023. I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë-Serbi, Miroslav Lajčák, i shoqëruar nga i dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, dhe këshilltarët e lartë nga Franca, Emanuel Bonne, Gjermania, Jens Plotner dhe Italia, Alessandro Cattaneo, erdhën në Prishtinë me një plan. U pritën nga kryeministri Albin Kurti në godinën e kryeministrit.

"Erdhëm me një plan, e diskutuam me Kurtin dhe do ta diskutojmë me Vuçiçin. Nuk do të jap detaje", tha Lajčák për gazetarët.

MESAZHI NE PRISHTINË: KURTI KA PËRGJEGJËSI PËR FORMIMIN ASOCIACIONIT

Në takimin me kryeministrit Albin Kurti diplomatët Perëndimorë i kanë kërkuar të themelojë sa më parë asociacionin e komunave me shumicë serbe dhe të punojnë sa më shumë për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës.

"Kurti ka përgjegjësi të bëjë progres në normalizim, nëse Kosova dëshiron të bëjë progres në BE. Duhet ta përsëris që Asociacioni të formohet pa vonesa. Pa këtë, s'do të ketë progres të Kosovës në integrimin evropian. E vlerësojmë gatishmërinë e Kurtit për të vazhduar diskutimet së shpejti. Tani do ta vazhdojmë misionin në Beograd, ku do ta takojmë presidentin Vuçiç"-tha Lajčák për gazetarët pas takimit me kryeministrit kosovar.

Në konferencë për mediat në Kosovë Lajčák u shpreh se çdo vonesë është e papranueshme dhe presin që Kosova dhe Serbia t'i përmbahen obligimeve të dialogut. "Çdo vonesë është e papranueshme dhe presim që Kosova

dhe Serbia t'i përmbahen obligimeve të dialogut. Sulmi nuk ndryshon faktin se Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje më herët këtë vit. Dialogu është më i rëndësishëm së kurrë, sepse nëse nuk ka dialog mund të përsëritet eskalimi, dhe kjo nuk është çka duam ne, as çka doni ju. Prandaj jemi këtu. E dyta, nuk ka alternativë tjetër pos dialogut, sepse dialogu sjell normalizim e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë dhe e hap rrugën evropiane për Kosovën dhe Serbinë", tha Lajčák.

ÇFARË THA KURTI?

Ndërsa Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti përmes një deklarate për median bëri të ditur se në takim kishte vendosur theksin tek siguria e shtetit dhe e qytetarëve, e kufijve dhe e territorit.

"Pas sulmit terrorist dhe kriminal të 24 shtatorit të kryer nga grupe paramilitare me mbështetje dhe pjesëmarrje të Serbisë, ndëshkimi është vendimtar për mospërsëritje", deklaroi Kurti pas takimit. Sa i takon dialogut, kryeministri kosovar theksoi se "është i nevojshëm reflektimi cilësor dhe një qasje e re". Nga Prishtina për Report Tv gazetari Venhar Isufi i cili ndoqi konferencën e emisarëve tha se ata i kanë prezantuar një draft për themelimin e asociacionit. Aludohet se është plani franko - gjerman dhe u kërkohet të dy liderëve të bëjnë hapa konkretë rreth këtij plani konkret.

PESESËHJA EDIPLOMATËVENËBEOGRAD: AUTORËT E SULMIT NË BANJSKË PARA DREJTËSISË

Pas takimit me presidentin e Serbisë Aleksandër Vuçiç në godinën e presidencës, Lajčák foli shkurt para

- **Lajčák:** Të hetohet plotësisht sulmi në Banjskë
- **Vuçiç:** Takimi me pesëshen diplomatike, i vështirë,
- **Kurti:** Urgjente siguria! Duhet qasje e re për dialogun
- **BE e NATO** vijon hetimet për sulmin në Banjskë
- **'Rrëzohet' Macron, KE për Report Tv:** Jo pezullime të vizave për Kosovën
- **Vuçiç para takimit:** S'më zë gjumi natën
- **Mediat:** Do sjellin draft-statutin e Asociacionit në Prishtinë
- **SHBA e BE në një zë:** Kosova e Serbia t'i kthehen dialogut!

gazetarëve duke thënë se qëllimi i vizitës ishte se si të arrihet progres në zbatimin e marrëveshjes për normalizim dhe depërshkallëzimin e e situatës pas ngjarjeve të fundit duke iu referuar sulmit në Banjskë.

Lajčák tha se "pesëshja" e dënon ashpër sulmin ndaj policisë së Kosovës më 24 shtator dhe se të gjithë autorët duhet të dalin para drejtësisë. Se presin bashkëpunim të plotë të Serbisë në këtë drejtim. Më tej shtoi se të dyja palët duhet të punojnë për depërshkallëzimin e situatës dhe normalizimin e marrëdhënieve.

ÇFARË THA VUČIÇ?

"Një takim i vështirë" e cilësoi presidenti Aleksandër Vuçiç.

"Besoj se në vijim do të gjejmë një rrugë për të dalë nga kriza. Pres takime të rëndësishme në Bruksel në ditët në vijim" shtoi më tej presidenti serb pas takimit, ndërsa ditën e sotme e kishte cilësuar si 'një nga ditët më të vështira për Serbinë' dhe për të personalisht, sipas agjencisë së lajmeve Beta.

Në Kosovë i pyetur nga gazetarët se në ç'pikë janë hetimet për sulmin në Banjskë, ku u vra në krye të detyrës Afrim Bunjaku, Lajčák u shpreh se po hetohet nga Bashkimi Evropian dhe nga NATO dhe se do të jepet një përgjigje përfundimtare së shpejti.

BE-ja dhe NATO janë duke hetuar faktet. Do të informoheni për rezultatet."-tha Lajčák.

Me këtë vizitë emisarët synuan të dërgojnë mesazhin se ekziston unitet mes Shteteve të Bashkuara dhe BE-së, që të punohet në zbatim të Marrëveshjes për normalizim të marrëdhënieve mes dy vendeve, të arritur në shkurt të këtij viti në Bruksel. Një muaj më vonë, në Ohër të Maqedonisë së Veriut, u arrit kompromis për aneksin e zbatimit të saj.

Edhe në samitin e mbajtur më 20 tetor mes SHBA-së dhe BE-së në Uashington, palët kanë bërë thirrje për zbatim të "shpejtë dhe pa kushte" të Marrëveshjes për normalizim të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, dhe që dy vendet t'i kthehen dialogut.

OPINION

Çdo zgjidhje do jetë e lidhur me njohjen e pavarësisë. Kosova është shtet i pavarur që nga viti 1999

KOSOVA DHE (PA)SIGURIA E VERIUT

Nga Bashkim Hisari

Pesëmbëdhjetë vjet pas shpalljes së pavarësisë, dhe pasi më shumë se gjysma e shteteve anëtare të OKB-së e kanë njohur pavarësinë e saj, çështja e Kosovës në skenën botërore ende rri pezull. Atë që kemi parë dhe dëgjuar javët e fundit na sugjeron se kriza kronike në Kosovë nuk po qetësohet. Eskalimi i tensioneve dhe shqetësimet për siguri janë bërë sfida me të cilat qytetarët e Kosovës vazhdojnë të përballen. Tensionet po i krijojnë ata që po e drejtojnë Serbinë, njerëzit që në tru nuk kanë mendime të pastra dhe janë “heronjë” pa mbulesë që duan ta ruajnë pushtetin me çdo kusht. Autoritetet serbe, klika e kriminelit Slobodan Millosheviq në krye me Vuçiq, Daçiç Vulin, Sheshel etj., krijuan një atmosferë se të drejtat e komunitetit serb në Kosovë mund të mbrohen vetëm me rezistencë fizike, me barrikada, me armë dhe sulme terroriste. Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, nuk është distancuar nga sulmi terrorist në veri.

TË SHITËNAT NDAJ POLICISË SË KOSOVËS - TË SHITËNA NDAJ PAQËS, JETËS NORMALE DHE SIGURISË

Vuçiq, si njeriu më i fuqishëm në Serbi, thotë: “... edhe fëmijët trembëdhjetë vjeçarë janë gati të marrin armët në Kosovë e Metohi”. Pra, nuk është për t'u habitur që më 24 shtator ndodhi sulmi terrorist ndaj Policisë së Kosovës. U vra rreshteri Afrim Bunjaku, dy policë u plagosën, dy të tjerë u lënduan. Në luftimet që u zhvilluan në manastirin e fshatit u vranë edhe tre sulmues nga grupi prej 90 serbëve dhe pjesëtarëve të formacioneve paraushtarake “Mbrojtja civile” dhe “Brigadat e veriut”. të strehuar në Manastirin e Banjskës në veri të Kosovës. Ata ishin përgatitur për një kohë të gjatë në bazat e trajnimit të ushtrisë serbe brenda Serbisë. Në ditët pas sulmit, Policia e Kosovës e gjeti dhe e konfiskoi një arsenal të jashtëzakonshëm armësh të sofistikuara që nuk mund të blihen në tregun lokal jashtë sistemit shtetëror. Armatimin e rëndë që vlersohet rreth 20 milionë euro, terroristët serbë e kishin fshehur në Manastir dhe e kishin transportuar me autoambulancë nga Serbia në veri të Kosovës.

Autoritetet kosovare, sulmin e cilësuan si akt terrorist sponsorizuar dhe urdhëruar nga Serbia me qëllim që të anekson veriun dhe të kërcënon sovranitetin shtetëror dhe sigurinë kombëtare. Serbia hodhi poshtë akuzat e Kosovës edhe pse përgjegjësinë për organizimin dhe sulmin në Banjskë e mori Millan Radojiçiq, ish-nënkryetari i Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve në Kosovë që ka mbështetur në Beogradit zyrtar. Më 3 tetor, Radojiçiq u arrestua në Serbi, u mor në pyetje por u lirua një ditë më vonë. Radojiçiq, dyshohet se ka lidhje me vrasjen e ish-politikanit serb të Kosovës, Oliver Ivanoviq dhe është vendosur në listën e sanksioneve të Departamentit të Thesarit të SHBA-së.

Bashkimi Europian dhe SHBA ishin shumë të qartë në reagimet për sulmet ndaj policisë së Kosovës. I dënuan sulmet, kërkuan që rasti të hulumtohet dhe përgjegjësit të nxirren para dre-



Terroristët serb në Banjskë të Zveçanit

jtësisë. Përsëritën mesazhet për domosdoshmërinë e sigurimit të paqes dhe stabilitetit në rajon, uljen e tensioneve, angazhimin konstruktiv për të arritur progres në dialog. NATO e shtoi numrin e pjesëtarëve të misionit paqeruajtës në Kosovë KFOR dhe rriti patrullimet në veri. Në Samitin e liderëve të BE në Granada, Kosova ishte në fokus, por vetëm në mënyrë deklarative, në thelb aty nuk u bë asgjë për tejkalimin e krizës ekzistuese dhe uljen e tensioneve sikurse edhe në Samitin e Berlinit në Tiranë që nuk solli ndonjë zgjidhje. Ditë më parë, Parlamenti Evropian miratoi një rezolutë me të cilën e dënoi ashpër sulmin në veri të Kosovës nga “paraushtarakët e mirë organizuar serbë” dhe “politikën e rrezikshme të Serbisë ndaj Kosovës”. Në takimet e fundit më 21 tetor emisarët perendimor në Prishtinës dhe Beogradit thanë se shtensionimi i situatës dhe normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë janë më urgjente se kurrë më parë dhe theksuan se sulmuesit në Banjskë duhet të sillen para drejtësisë.

Mirëpo, përkundër dëshmiave të qarta të aktiviteteve terroriste dhe mbështetjes së terrorizmit nga regjimi i Vuçiqit, faktori ndërkombëtar nuk zbatoi sanksione ndaj Serbisë dhe nuk i hoqi masat ndëshkuese ndaj Kosovës që u vendosën më parë!

NË KOSOVË, SERBIA KREU KRIMET MË TË RËNDA TË LUFTËS

Tani më, shumica e shteteve të botës, pajtohen se në dekadën e fundit të shekullit të kaluar, serbët kanë kry krimet më të rënda në territorin e ish-Jugosllavisë. Gjatë konflikteve brutale të armatosura të viteve 1998/1999 në Kosovë, forcat serbe kanë kry rreth 400 masakra, vranë mbi 13.500 persona, gra e pleqë dhe 1432 fëmijë, prej tyre 239 të moshës deri 5 vjeçë. Të zhdukur me dhunë ishin 1658 njerëzë. Numri i viktimave të dhunës seksuale llogaritet të jetë rreth 20.000. Shkaktuan dëme enorme materiale. Nga Kosova u dëbuan me force mbi 800.000 shqiptarë. Për krimet ndaj shqiptarëve të Kosovës, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë shqiptoi dhjeta aktgjykime kundër politikanëve dhe komandantëve ushtarakë të Serbisë. Regjimi terrorist kriminalo-populist i radikalit patologjikisht, shmanget nga balla-



Arsenali i armëve i sekuestruar nga Policia e Kosovës në manastirin e Banjskës

faqimi me realitetin e Kosovës, ende vazhdon t'i mohoj krimet dhe gjenocidin e ushtruar dhe tregon përralla të çmendura për ruajtjen e integritetit territorial. Krijon tensione dhe destabilizon gjithë rajonin sepse në krye të shtetit ka kriminelë dhe profiterë nga lufta, fytyra dhe duarët e të cilëve janë të lyera me gjak. Ata nuk po distancohen nga politika e kriminelit Millosheviq. Me sulmet terroriste në Banjskë, Serbia dëshmoi se nuk është e interesuar për deshkallzimin e tensioneve, se s'do bashkëpunim dhe se nuk është e interesuar për dialog me ndihmën e BE dhe SHBA, por dëshiron aneksimin e veriut të Kosovës. Andaj, rreziku nuk është neutralizuar tërsisht dhe nuk është skenar që nuk mund të përsëritet.

VUÇIQ PO VEPRON SI MILLOSHEVIQI NË VITETË 90-TË DHE PUTIN ME ANEKSIMIN E KRIMESË

Presidenti serb Vuçiq po bënë atë që nuk ka mundur të bëjë gjatë regjimit të Millosheviqit. Ai, tash, çartazi po tenton aneksimin e veriut të Kosovës. Në sulmet terroriste ndaj Policisë së Kosovës, Radojiçiq ishte organizator dhe ekzekutor i urdhërave të Vuçiqit i cili këtë kriminel e quajti “hero të lirisë”. Lartësoi tre terroristët serbë që e sulmuan Policinë e Kosovës dhe shpalli zi për ta. Pa asnjë argument akuzon kryeministrin e Kosovës Albani Kurti se është “terroristi i cili vret dhe terrorizon popullin serb”. Vazhdon me veprimet provokuese duke urdhëruar dislokimin e njësjive të artilerisë, tankeve dhe këmbësorisë serbe përgjatë kufirit me Kosovën. Dekada e sundimit të Vuçiqit u shënuar me rënjen e vazhdueshme të demokracisë në Serbi, e cila gjithnjë e më shumë po bëhet shtet autoritar. Gjatë bisedave në Bruksel, Vuçiq tregon pajtueshmëri

të rreme për zbatimin e marrëveshjeve që ofrojnë zgjidhje për normalizimin e marrëdhënieve. Prandaj, nuk ka arsye për të besuar se lidhshipi politik serb është i interesuar ta çojë Serbinë në BE.

SËRBIA NUK KA HEQUR DORË NGA IDEJA E SERBISË SË MADHE

Lojërat politike të autoriteteve në Beograd që të mashtrajnë qytetarët e Serbisë po vazhdojnë. Ende dëgjoen argumente krejtësisht të falsifikuara dhe të rreme që na kujtojnë fjalimet e viteve të 90-ta që tashmë janë bërë interes kombëtar dhe dëshmojnë se Serbia nuk ka hequr dorë nga ideja e Serbisë së Madhe.

Qëndrimet e tyre paraqesin rrezik për qëndrueshmërinë në rajon për çfarë mbajnë përgjegjësi politike. Ata janë pjesë e problemit dhe jo zgjidhja. Në Serbi, terroristët po shpallen hero, po rehabilitohen udhëheqësit çetnik-profashistë serbë të cilët po trajtohen si atëdhetar. Në ditën kur në Tiranë u mbajt Samiti i Berlinit ku liderët e BE bënë thirrje për paqe e bashkëpunim dhe në prag të shënimit të ditës së çlirimit nga nazifashizmi, në Beograd u hap një dhomë përkujtimore në të cilën u vendos shtatorja e Drazha Mihailoviqit, një komandant çetnik, kriminel luftime, i cili bëri vepra të tmerrshme dhe krime të mëdha kundër popullatës joserbe. Në këtë manifestim mori pjesë një numër i madh qytetarësh, kryesisht adhures të figurës dhe veprës së shërbëtorit fashist, vendi i të cilit është në shportën e plehërave të historisë, jo në muze. Gjithçka që u dëgjua atje ishte një falsifikim i pastër i historisë, një hap drejt fashizimit shtesë të shoqërisë serbe, tallje e historisë, mohim i viktimave të fashizmit dhe një përpjekje për të përshtatur historinë për nevojat e përditshme politike të regjimit aktual. Prandaj, është e mundur që zgjidhja e çështjes së Kosovës të zgjatet.

NDËRHYRJA E NDËRKOMBËTARËVE DHE ARRITJA E NJË MARRËVESHJEJE-ÇËSHTJE URGJENTE

Kosova është e vetëdijshme se rruga e saj drejtë BE-së kalon përmes dialogut dhe normalizimit dhe se çdo përshkallëzim i mëtejshëm ka efekt të keq në atë proces, por edhe në stabilitetin e rajonit. Andaj është e përkushtuar për zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara, dhe është rreshtuar në aleancën e lirisë. Padyshim, me ndërgjegjëjen, moralin, politikën e saj do të gjykojë drejtë ngjarjet e fundit do sigurojë unitetin e të gjitha farcave politike për të përdorur arsyen e vetëdijshme për eliminimin e rrënjëve, shkaqeve të marrëveshjeve ndëretnike me serbët që janë të kahershme. Por, çdo zgjidhje do jetë e lidhur me njohjen e pavarësisë. Kosova është shtet i pavarur që nga viti 1999. Ka kohë që është shënuar fundi i luftës që Serbia e bëri dhe e humbi në Kosovë. Në koordinim dhe bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar do të angazhohet që sa më shpejtë të arrihet një marrëveshje konkrete për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi. Nëse situata aktuale mbetet e njëjtë dhe ballafaqimi me realitetin zvarritet, atëherë, ditët e vjetra tragjike do vazhdojnë të jetojnë me ne dhe në ne.

EVENIMENT

Përshëndetje e Kryesisë së SHAK "Labëria", "Nderi i Kombit" Dega Tiranë

OBVL, SESION SHKENCOR PËR ÇETËN E GOLLOBORDËS

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ (OBVL), në bashkëpunim me bashkitë e Dibrës dhe Bulqizës, organizoi më 7 tetor 2023 sesionin shkencor me temë: "Çeta antifashiste dhe partizane e Gollobordës me komandant Ahmet Fetah Camin".

Pas ekzekutimit të himnit kombëtar, qindra pjesëmarrësit që kishin mbushur sallën e madhe të Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë, ndoqën me vëmendje dhe interes të veçantë filmin dokumentar kushtuar Çetës partizane të Gollobordës dhe veprimtarisë atdhetare të dëshmorit Ahmet Fetah Cami - pjesemarrës i dy Lufrave Botërore dhe komandant i kësaj çete, me skenar dhe regji të Tefta Camit - ish ministre e Arsimit dhe Kulturës.

Në këtë sesion shkencor të moderuar me kompetencë shkencore nga Prof. dr. Paskal Milo, u mbajtën katër kumtesat si vijon:

- Ahmet Cami-biografi e shkruar me gjak si pjesëmarrës i dy lufrave botërore - nga Halil Rama-Mjeshtëri i Madh;
- Krijimi i Çetës Antifashiste të Gollobordës në janar të vitit 1940 dhe kthimi në Çetë partizane nga komandanti Ahmet Cami në maj të vitit 1943 - nga historiani, dr. Kadri Dauti;
- Dukuri luftarake për Çetën partizane të Gollobordës - nga Prof. asoc. dr. Bernard Zotaj;
- 80-vjetori: Lufta për mbrojtjen e qytetit të Peshkopisë në vitin 1943- nga Dr. Asllan Zemani.
- Lufta e çetave partizane të Batalionit të Dibrës dhe të Çetës partizane të Gollobordës për çlirimin e viseve shqiptare përtej kufirit dhe të qytetit të Dibrës së Madhe në vitet 1943-1944 kundër forcave pushtuese nazifashiste - Nga Prof. dr. Nebi Dervishi (publikuar në sesion, pa praninë e tij, për arsye familjare).

Kryesia e OBVL falenderon të gjithë pjesëmarrësit nga Shqipëria e Kosova që na nderuan me praninë e tyre.

Në emër të Kryesisë së SHAK "Labëria", "Nderi i Kombit" Dega Tiranë, Kryetari Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI i dërgoj këtë përshëndetje Sesionit Shkencor me temë: me temë: "Çeta antifashiste dhe partizane e Gollobordës me komandant Ahmet Fetah Camin".

Të nderuar organizatorë të ceremonisë së shqiptarit të pamposhtur Ahmet Cami

Të nderuar familjarë, miq e të ftuar. Ndehemi thëllësisht të nderuar, t'ju drejtohem këtij audience të përzg-

• *Shqipëria është kaq e vogël se të tillë na dëshën pushtuesit, por mbijetesa e kombit tonë qëndron tek gjaku dhe sakrificat e mbi të gjithë tek e ardhmja që gargantuan bijtë e Dibrës dhe gjithë Shqipërisë në luftën e lavdishme të formacioneve nacionalclirimtare*



jedhur sot në këtë ditë përkujtmore të shqiptarit të pamposhtur, komandantit dhe luftëtarit, dëshmorit të lirisë, heroit të kombit Ahmet Cami dhe çetës partizane antifashiste të Gollobordës, që komandant Ahmeti Krijoi.

Është krenari mbarë labe, por dhe gjithë shqiptare kur nderohen bijtë e kombit shqiptar, që jetën e bënë fli për Atdheun. Është krenari kombëtare të kujtosh gjithashtu përvjetorin e krijimit të çetës partizane antifashiste të Gollobordës, që u shqua për trimëri, besë e nder për antifashizëm të flaktë dhe patriotizëm.

Është pjesë e rëndësishme e gjithë formacioneve antifashiste shqiptare, që rrugën e vet e mbuloi me lavdi duke nderuar dhe ngritur më lartë famën e nëntë maleve të Dibrës sonë.


Shqipëria është kaq e vogël se të tillë na dëshën pushtuesit, por mbijetesa e kombit tonë qëndron tek gjaku dhe sakrificat e mbi të gjithë tek e ardhmja që gargantuan bijtë e Dibrës dhe gjithë Shqipërisë në luftën e lavdishme të formacioneve nacionalclirimtare.

Prandaj për të nderuar dëshmorët dhe heronjtë të fshatit Viçisht, por dhe të krejt Qarkut të Dibrës, të familjeve me tradita atdhetare sikurse ishte komandanti dhe intelektual i shquar Ahmet Fetah Cami, i cili tashmë ka hyrë në analet e historisë shqiptare si pjesëtar aktiv i dy luftërave botërore dhe

veçanërisht si themelues dhe komandant i Çetës të Gollobordës, që u bë flamur lirie që në ditët e para të krijimit. Ahmet Cami priti me indinjatë pushtimin fashist Italian të 7 prillit prandaj që ditën e parë të pushtimit u fut në zyrë dhe përgatiti një deklaratë që lidhet me betimin përpara flamurit për ti shërbyer shtetit shqiptar dhe jo të huajve, prandaj dha dorëheqjen si oficer dhe ju përkushtua nderit, dhe besës shqiptare si një dibran i mençur.

Në janar 1940 organizon dhe ngre çetën atdhetare antifashiste të Gollobordës, ku si komandant zgjidhet Ahmet Cami e zv/komandant Ukë Dan Cami. Ai ishte ndër përfaqësuesit më të zëshëm të 9 Maleve të Dibrës që kanë funksionuar edhe gjatë viteve të para të LANÇ-it deri në maj të vitit 1943, kur u asgjësuan si armiq disa nga krerët, që bashkëpunuan me pushtuesit nazifashistë. Tradita historike të Nëntë Maleve të Dibrës i dha zë dhe forcë gjithë Atdhetarisë për tu përleshur me fashizmin dhe për të triumfuar mbi të. Nderi i dibranit dhe gjithë shqiptarisë ishte lufta pa kompromis, luftë që Ahmet Cami dhe shokët e tij e justifikuan dhe derdhën gjak sikurse kishin derdhur edhe në lufrat e mëparshme. Prandaj dhe nderohen e respektohen në breza për tre breza dëshmorësh.

Nga formacioni i çetës u kalua në krijimin e batalionit partizan me 23 korrik






1943 në fshatin Gjoricë e Epërme dhe organizator ishte Ahmet Cami.

Ahmet Cami dha për Luftën Antifashiste, për lirinë e pavarësinë e Atdheut gjithçka kishte, shkriu të gjithë pasurinë e tij, duke dhënë dhe jetën. Akti i heroizmit të Ahmetit dhe të shokëve të tij, e frymëzuan çetën e Gollobordës, për ta vazhduar më me guxim e heroizëm luftën për çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit nazistë. Lavdi në përjetësi dëshmorit Ahmet Cami dhe çetës heroike të Gollobordës! Lavdi dëshmorëve të Dibrës dhe gjithë Shqipërisë!

***Përshëndetje e Kryesisë së SHAK "Labëria", "Nderi i Kombit" Dega Tiranë në kuadrin e aktivitetit për nder të luftëtarit dhe prijësit në dy lufrat Ahmet Cami, patrioti i shquar e atdhetar i rrallë si dhe çetës partizane antifashiste të Gollobordës**



Nga e majta në të djathtë, nga lart poshtë: Shahin Muharrem Cami; Sul Sal Cami; Tufik Isuf Cami; Izet Sal Cami; Adem Bajram Cami; Ahmet Fetah Cami; Abdulla Shaban Cami (Dulla); Beqet Isuf Cami; Islam Bajram Cami (Lami); Muharrem Mustaf Cami (Rremi); Selim Mjeshtëri; I paidentifikuar; Kosovari; Hider Rahman Cami; Destan Çup Cami; I paidentifikuar; Ajif Lam Cami; Liman Beqir Cami; Mustaf Veli Cami; Hasan Beqir Cami; Uke Abdulla Cami; Rifat Veli Cami



Abdulla Shaban Cami

Uke Abdulla Cami

Sinan Shaban Cami

Esat Sinan Cami

Ahmet Cami

Tri kunatat, Bejazja, Nazmija dhe Fitneti

REAGIMI

Drejtori i Arkivit të Shtetit, boton një libër rreth vetidentifikimit etnik në Shqipëri

Censusi – “Beteja për 20 përqindëshin” në librin e Ardit Bidos



Halil Rama – Mjeshtër i Madh

Libri i sapo botuar “Beteja për 20 përqindëshin” (Fluiditeti i identitetit, statistikave demokrafike dhe implikimet politike në Konispol dhe Himarë) i autorit Ardit Bido, i referohet tematikës së vetidentifikimit etnik, të përqindjes së pakicave greke në Himarë dhe në Konispol, si edhe të ndërhyrjeve të huaja potenciale në procesin e censit të popullsisë dhe të banesave, që përbën ngjarjen statistikore më të rëndësishme të vendit. I botuar kohë më parë në disa cikle studimesh në shtypin e përditshëm dhe së fundmi në një libër të llojit dhe stilit të veçantë, “Beteja për 20 përqindëshin” (në dy gjuhë: shqip dhe greqisht) ka gjetur jehonë të gjerë në opinionin publik shqiptar dhe ka marrë vlerësime maksimale nga personalitete akademike e të letrave. Kjo edhe për faktin se është në koherencë të plotë me realitetin e sotëm, kur përmes debatesh e konfliktesh mes përfaqësuesve të komuniteteve të ndryshme në Shqipëri po zhvillohet censusi i popullsisë dhe banesave.

Ardit Bido, profesor i asociuar në marrëdhënie ndërkombëtare, me fushë të ngushtë studimi raportin mes politikës, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe fesë e pakicave, përmes studimeve të thelluara shkencore, trajton me kompetencë dhe profesionalizëm tema të tilla si: Krijimi i identitetit etnik dhe kombëtar; Fluiditeti i identitetit etnik dhe kombëtar; Vetëdeklarimi si forma e vetme e vetëidentifikimit dhe vetëdeklarimi i rremë etj. Bido, i cili krahas dhjetra studimeve të botuara në revista shkencore e kumtesave të mbajtura në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, është autor i monografisë “Kisha Ortodokse Shqiptare: një histori politike (1878-1945), në librin e tij të ri “Beteja për 20 përqindëshin” u referohet fakteve se: Himara, 14.5 % grekë është maksimumi i vetëidentifikimit dhe se: Konispoli 13 % grekë është maksimumi i vetëidentifikimit. Me kurajo, kompetencë e profesionalizëm, prof.Bido u kundërvihet kërkesave greke për Himarën e Konispolin pas vitit 1991, si dhe përhapjes së influencës greke, referuar legjislacionit shqiptar e grek dhe “testeve” të viteve 2011 e 2015. “Ajo që autorët grekë quajtën tentativa për dëmtimin e shtyllës shoqërore dhe kombëtare shqiptare përmes tregtisë së vizave të viteve ‘90, në fakt ishte përpjekja e shtetit grek për të zgjeruar hartën e minoritetit në Shqipëri”, shkruan Bido ndër të tjera në këtë libër (fq.61). Në përfundim të kësaj të vërtete të pamohueshme, përmes studimesh të thelluara, autori i këtij libri me një bibliografi mjaftë të pasur (32 burime parësore dhe 54 burime dytësore) arrin në konkluzionin se: “Shteti grek, struktura të tij dhe/ose grupe interesi, përmes mekanizmave dhe politikave shtetërore greke, kanë tentuar vazhdimisht prej vitit 1991, të ndikojnë në rritjen e numrit të grekëve në Shqipëri, përmes përpjekjeve për të greqizuar këto grupime me fluiditet të identitetit etnik, por edhe grupime pa identitet fluid, si shqiptarët e fshatrave ortodokse në zonat e përqëndrimit të minoritetit grek”. Parë nga ky vështrim, prof. asoc. Dr. Sonila Boçi, përtej ekzaltimeve nacionaliste që i dëgjojmë shpesh në mediet dhe rrjetet sociale, duke folur për identitetin si një tipar shoqërisht të negociuashëm, i cili varet nga kontekstet

- Prof. asoc. Dr. Sonila Boçi, përtej ekzaltimeve nacionaliste që i dëgjojmë shpesh në mediet dhe rrjetet sociale, duke folur për identitetin si një tipar shoqërisht të negociuashëm, i cili varet nga kontekstet historike, politike e sociale, e ka perceptuar librin e prof.Ardit Bidos si një ftesë për reflektim të thellë dhe racional.

historike, politike e sociale, e ka perceptuar librin e prof.Ardit Bidos si një ftesë për reflektim të thellë dhe racional.

Veç të tjerash këtë libër e bëjnë të besueshëm shtojcat (1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9) për përqindjet e grekëve në Himarë dhe Konispol; Diapazoni i vetëdeklarimit, minoritetit dhe fluiditetit në Himarë e Konispol; Përbërja etnike, gjuhësore dhe fetare, sipas vendbanimeve të bashkive Konispol, Finiq, Sarandë, Delvinë e Himarë; Të dhënat e kombësisë sipas Regjistrimit të Gjendjes Civile për vendbanimet e bashkive Himarë dhe Konispol në censuset e viteve 1923 dhe 1945, sipas ndarjes së sotme administrative. Libri “Beteja për 20 përqindëshin” (Fluiditeti i identitetit, statistikave demokrafike dhe implikimet politike në Konispol dhe Himarë) i autorit Ardit Bido ilustron me harta dhe fotografi mjaftë interesante për



Ardit Bido është profesor i asociuar në marrëdhënie ndërkombëtare, me fushë të ngushtë studimi raportin mes politikës, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe fesë e pakicave. Ai ka mbrojtur gradën «Doktor i Shkencave» në Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Tiranës, lëmë në të cilën ka kryer edhe studimet Master. Çiklin e parë të shkollës së lartë e ka përfunduar për Gazetari në të njëjtin universitet. Krahas dhjetra studimeve të botuara në revista shkencore e kumtesave të mbajtura në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, ai është autor i monografisë “Kisha Ortodokse Shqiptare: një histori politike (1878-1945)”, botuar në serinë më të aklamuar në fushën akademike për raportin fe-politikë, nga shtëpia botuese “Routledge”. Ardit Bido ka një përvojë disavjeçare në shtypin e shkruar dhe mediat audiovizive, si dhe ka menaxhuar departamentet e komunikimit të disa institucioneve akademike, shtetërore dhe private. Prej vitit 2012, është pedagog pranë Universitetit të Tiranës dhe Universitetit Metropolitan Tiranë. Ai ka pasur angazhime publike dhe komunitare, duke përfshirë drejtimin e disa organizatave rinore, pjesëmarrjen në borde drejtuese universitare e kërkimore dhe zgjedhjen si nënkryetar i Këshillit Bashkiak të Njësisë nr. 9 në Tiranë. Prej vitit 2016, mban detyrën e drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave.

studiues të kësaj fushe.

FLUIDITETI I IDENTITETIT ETNIK NË OPTIKËN E PROF. BIDOS

Ashtu si në Hyrje të librit edhe gjatë prezantimit të tij në një nga sallat e Hotel “Tirana International” në Tiranë, ku merrnin pjesë qindra personalitete akademike e të letrave, autori Bido shpjegoi se shtypa për realizimin e këtij studimi ishte identifikimi i grupimeve të caktuara të popullsisë shqiptare me identitet fluid. “Fluiditeti i identitetit etnik është një koncept shkencor, shumë pak i trajtuar në Ballkan, nuk është vetëm tek ne. Në Ballkan është shumë pak i trajtuar, ku ne lidhim automatikisht popullsinë me origjinën. Kjo sipas tij, për të dalë rrjedhimisht në përfundime statistikore të besueshme, të cilat na japin një ide më të qartë se sa janë individët që ndihen në një etni të caktuar. Bido theksoi riskun e vetëdeklarimit të rremë në censusin 2023, siç ka ndodhur në një fshat në censusin e vitit 2011, duke rrëfyer implikimet politike që do të kishte Shqipëria nëse artificialisht numri i pakicës greke tejkalon 20%, që statistikisht është e pamundur edhe përmes vetëidentifikimit. Më tej, Bido u ndal në çështjen e vetëidentifikimit etnik, duke pohuar se libri ka përfshirë në trajtesë qasjen klasike primordialiste dhe atë moderniste, me qëllim pasqyrimin sa më objektiv të problematikës. “Unë nuk i përkas vetë shkollës primordialiste, unë nuk besoj se ato që kemi të regjistruar në gjendje civile janë të sakta. Por, unë në libër i qëndroj në mënyrë shumë të qartë të gjitha koncepteve, qoftë primordialiste, qoftë moderniste të vetëidentifikimit”, pohoi prof. Bido.



VLERËSIME TË PERSONALITETEVE

Ky prezantim i moderuar në formën e një forumi prej gazetarit Aleksandër Çipa, u zhvillua në praninë e ish-presidentëve të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu dhe Bamir Topi, të nënkryetares së Kuvendit, Ermonela Felaj, të një grupi parlamentarësh të mazhorancës dhe të opozitës, të akademikëve, të studiuesve të historisë, të përfaqësuesve të klerit dhe të qarqeve diplomatike. Në panelin e diskutimit, krahas autorit, morën pjesë Prof. Dr. Ksenofon Krisafi, ish-ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Prof. Dr. Paskal Milo, Prof. Dr. Irakli Koçollari, Prof. Dr. Eva Hyskaj dhe Prof. Dr. Fatmir Mema. Ata e vlerësuan librin “Beteja për 20 përqindëshin” të autorit Ardit Bido të një rëndësie të veçantë, për vetë faktin se ai është në koherencë me realitetin e sotëm kur në Shqipëri po zhvillohet censusi i popullsisë dhe i banesave.

Prof. Dr. Ksenofon Krisafi theksoi se përgjegjësia për vetëdeklarim objektiv i përket organeve shtetërore. “Nuk mund të thuash ti që unë jam kinez, tajlandez se kështu më mbushet mendja mua tani, por duhet objektivisht të vërtetosh dhe kjo është detyrë e shtetit, në këtë rast e zyreve civile dhe të autoriteteve të tjera që janë të ngarkuara me këtë çështje” shprehu Krisafi. Në vijim të diskutimit Prof. Dr. Paskal Milo nënvizoi se problematikën e adresuar në libër duhet të gjejnë zgjidhje nga elitat politike dhe akademike. “Ne duhet të jemi realistë mbi disa realitete lokale, veçanërisht në tre fshatrat greqishtfolëse të Bashkisë Himarë dhe duhet të nisemi gjithnjë nga parimet e Konventës Kuadër për Pakicat” tha z. Paskal Milo.

Profesor Irakli Koçollari këtë botim e cilësoi si një hap mjaft të rëndësishëm për vendin. Gjatë diskutimit, në fjalën e tij Koçollari tha: “Deri tani në realin e studiuesve shqiptarë nuk ka qoftë edhe një të vetëm që të jetë marrë me çështjet nacionale, të origjinës së kombit tonë, në mënyrë specifike të identitetit nacional të shqiptarëve.

Sigurisht, kjo nuk është e vetmja zgjidhje, e fundit dhe përfundimtare në atë që ka bërë. Ky është një hap, është siç thonin dhe latinët e lashtë ‘një dallëndyshe’”. “Pyetësori duhet të shtrohet në debat për mendimin tim, me studies, me grupe studiuesish të fushave të ndryshme, pasi kemi studiues shumë të mirë dhe pastaj do të dinim nëse duhet të ishin apo jo këto dy pyetje” tha mes të tjerash Prof. Dr. Fatmir Mema.

Prof. Dr. Eva Hykaj vlerësoi që ky botim do të jap ndihmesë dhe kontribut në njohjen e problematikave të shqyrtuara. “Duke u ndikuar nga politika, njerëzit vetëndjehen, vetëdeklarohen rrejtazi ose jo. Normalisht, nëse kjo është çështje e përditshmërisë, ose nëse është e pritur të ndodhë, njerëzit do ta kuptojnë më mirë nëpërmjet botimit të Arditit” shprehu në diskutim Prof. Dr. Eva Hykaj.

Moderatori i këtij Forumi z. Aleksandër Çipa, President i Unionit të Gazetarëve të Shqipërisë çmoi se përmes këtij botimi faktik, kontribuohet në rikthimin e “Shqipërisë së mendimit”.

“Shqipëria, në rastin konkret, përmes akteve dhe natyrisht forumeve të tilla, të rikthejë atë që quhet sentenca e Branko Merxhanit, Shqipërinë e mendimit. Arditi jep një kontribut për të rikthyer përmes të dhënave dhe fakteve logjike, Shqipërinë e mendimit” nënvizoi z. Çipa.

Prof. asoc. Dr. Sonila Boçi, në parathënien e librit, ndër të tjera nënvizon faktin se para 12 vjetësh, regjistrimi i popullsisë u shqoqërua me debate mjaft të ashpra dhe me mosbesim të shprehur për rezultatin e tij. Në analizën e saj “Punimi i prof. Ardit Bidos ‘Beteja për 20 përqindëshin: Fluiditeti i identitetit, statistikave demokrafike dhe implikimet politike në Konispol dhe Himarë’, vjen në kohën e duhur, dke na sjell një qasje shumëdimensionale për një çështje tepër të komplikuar”.

Më tej, në këndvështrimin e saj analitik, Prof. asoc. Dr. Sonila Boçi shprehet se: “Teorikisht, lundrimi në koncepte të tilla të komplikuarra si: nacionalitet, përkatësi etnike/kombëtare dhe identitet etnik/kombëtar, nuk është një ndërmarje e lehtë, pasi defnicionet dhe analizat ndryshojnë jo vetëm ndërmjet shkollave të mendimit, por edhe midis autorëve të së njejtës shkollë”. Gjithsesi, konkludon prof. Sonila Boçi, autori i këtij libri, prof. Ardit Bido, gjen një këndvështrim mjaftë interesant.

OPINION

“Izraeli, e drejta për mbijetesë dhe mbrojtjen e vlerave të qytetërimit”!

Gjeneral © Piro Ahmetaj

Kam ndjekur me vëmendje të shtuar, sigurisht i “shokuar nga pasojat”, por dhe “profesionalisht i zhgënjyer” nga dështimi i Inteligjencës dhe sistemit të mbrojtjes Izraelite, kur në 7 Tetor 2023, Hamasi (i shpallur organizatë terroriste nga ShBA/BE) goditi me breshëri raketash qytetarë të pafajshëm të grumbulluar në festë publike.

Paraprakisht, nëpërmjet rrjeteve sociale por edhe miqve/kolegëve të fushës të sigurisë në Jeruzalem/Telaviv, kam shprehur dhimbjen njerëzore për mijëra “jo viktimat”, por dëshmorët e luftës kundër terrorizmit barbar.

Ndërsa në këtë artikull, do përpiqem të hedh dritë me: (I) konsideratat gjeopolitike rreth sulmit terrorist; (II) historinë e konfliktit dhe përpjekjeve për paqen në rajon; (III) peshimin (edhe pse s’ka të krahasuar) të fuqisë ushtarake; (IV) rekomandime për rikthimin e bashkëjetesës paqësore, si dhe (V) impakte dhe këshilla gjeopolitike për aktorët politike të Tiranës dhe Prishtinës Zyrtare. Më konkretisht:

I. Shtatë mësimet & 7 mesazhe strategjike nga akti terrorist i 7 Tetorit 2023:

Së pari, për të dy shtetet sovraane (R.Sh & Kosovë) të një Kombi nuk ka opsion të dytë, përveçse ti bashkohej/t pa hezitim “flamurit të solidaritetit të mbarë botës së qytetëruar” duke dënuar pa hezitim frymëzuesit politik dhe autorët e akteve kriminale të Hamasit, të cilët duke goditur barbarisht mbi popullsinë e pafajshme Izraelit, e skalitën 7 Tetorin 2023 si një ndër aktet terroriste nga më çnjerëzoret në historinë moderne të njerëzimit.

Nga ana tjetër, më e pakta i gjej qesharake që “opinionistët të vetë-prangosur nga sindroma e Stockholm” i risjellin opinionit oshilacionet gjeopolitike të Enver Hoxhës: “Izraeli një kobure në duart e SHBA/UK..., një Shtet i krijuar nga imperializmi dhe sionizmi reaksionar”.

Së dyti, përtej emërimit patriotiko-fetar (HAMAS = Lëvizja e Rezistencës Islamike) “terroristët e pa Fe” që çirren si monstra: “Allahu akbar ose Zoti është i madh” edhe pasi vrasin barbarisht qytetarë të grumbulluar në festë publike; kur u presin kokat fëmijëve të pafajshëm; kur marrin zvarrë pengje pleq/gjyshër, gra dhe vajza, apo edhe kur përdorin si barrikada (ç) njerëzore bashkëqytetarë nga Rripi i Gazës, kurrësesi nuk kanë të përbashkët me kuranin dhe as me vlerat e fesë Islame!

Në të kundërt, frymëzuesit që fshihen si minj në transhetë e Rripit të Gazës, e keqpërdorin fenë për axhendën e tyre politike dhe i diskreditojnë vlerat e besimit Islam, që në asnjë rrethanë nuk frymëzon vrasjet makabre. Në të kundërt, si besimet e tjera komplementare, edhe ajo Islame mbjell paqe, tolerancë, mirëkuptim dhe bashkëjetesë paqësore, pavarësisht Fesë, etj.

Së treti, ende mbetet në kuadrin e teorive konspirative nëse ky akt ishte “klonuar nga Kremli në kokën e terroristeve të Hamasit”, por është e sigurt, që ky akt-barbar, i shërbën përpjekjeve të dëshpëruara të Rusisë/Putinistëve, për të hapur një front të ri lufte krahas asaj në Ukrainë. Por do të dështojë, ashtu si në përpjekjen për ta tërhequr Kinën në luftë me Tajvanit; apo për ta frymëzuar Beograd-in deri në marrëzinë e “pushtimit ushtarak të veriut të Kosovës, e cila prej Marrëveshjes së Kumanovës (06/1999) mbetet ende nën përgjegjësinë e trupave të NATO-s/KFOR-it”.

Së katërti, ashtu si 11 Shtatori 2001, edhe kjo ngjarje demonstroi jo vetëm “dështimin e frikshëm” të inteligjencës Izraelite, por 7 Tetori 2023, konfirmoi gjithashtu se, “garancia 100% të mëvetësia e mbrojtjes strategjike si dhe imunitet 100% në luftën kundër terrorizmit nuk ka për të patur”. Bashkë me këtë mësim,



del domosdoshmëri kritike, për të bashkëpunuar në luftën me të keqen e përbashkët/terrorizmin.

Së pesti, në Kremlin, Iran, Korenë e Veriut, dhe gjithandë (përfshi në Shqipëri) në mendjet e ndryshkura duke u përpjekur ti japin dimension fetar dhe “legjitimuar” aktit terrorist, që: “vret barbarisht apo ngre barikada/pengje me trupa njerëzore të pafajshëm”, kanë vënë në sprovë, të drejtën sovraane dhe ndërkombëtare (artikulli 2 dhe 51 i kartës së OKB) të vendimmarrjes për (vetë) mbrojtjen me çdo çmim të integritetit teritorial, të jetës së qytetarëve dhe përdorimin e fuqisë ushtarake të Izraelit deri në asgjësimin e autorëve, terroristeve të Hamasit.

Së gjashti, ndërsa përtej rrethanave specifike të Izraelit për mbijetesë, “ushtrimi i të drejtës së hakmarrjes shëmbullore ndaj terroristeve”, vjen edhe si një sfidë dhe kampionë e përbotshme, pasi: “nëse terroristet e Hamasit, duke vlarë/therur fëmijët të pafajshëm apo duke përdorur si barrikada, pengje, pleq/gjyshër, vajza dhe gra, etj. akte çnjerëzore”, do të gjuhëzojë Izraelin, nuk do krijonte kjo një precedent fatal për të hedhur në erë rregullat, sistemin e sigurisë dhe vlerat e qytetërimit?

Ndërsa, për këdo kalemxhi të mirëpaguar, pyetja mbetet: “nëse Izraeli dorëzohet sot, dhe nesër në një akt të ngjashëm kështu do gjuhëzohej edhe Ëashingtoni, Berlioni, Londra, Parisi dhe çdo vend demokratik ndaj terroristeve çfarë pasojash do të ketë mbi paqen, shoqërinë njerëzore, harmoninë fetare, bashkëjetesën paqësore” ?!

Nga ky këndvështrim, pra kur Izraelit nuk mbetet opsion tjetër, “hakmarrjen shëmbullore ndaj organizatës terroriste të Hamasit”, e gjej në të drejtën e mbijetesës si dhe kontribut për të mbrojtur vlerat e mbarë botës së qytetëruar!

Së shtati, mbështetja diplomatike nga vendet demokratike si dhe prezenca e menjëhershme ushtarake e ShBA në rajon (e cila konfirmon “me vepra” mbështetjen pa kompromis të Izraelit në luftën me terrorizmin) është jo vetëm për shkak të një lobi të fortë në vendimmarrjet e Ëashingtonit. Ndërsa kështu, marrëdhëniet ShBA-Izrael meritojnë edhe një koment shtesë: “shumica dërrmuese e 194 shteteve (përfshi Shqipërinë) e kanë vetëshpallur ShBA aleat strategjik,

ndërsa Izraeli është ndër të vetmet shtete të konfirmuara zyrtarisht nga Ëashington-i si aleat Strategjik për mbrojtjen e interesave gjeopolitike të ShBA-ve në rajon”!

II. HISTORIA E KONFLIKTEVE DHE E PËRPJËKJEVE PËR PAQE :

Përtej aktit terrorist të 7 Tetorit, konfliktet dhe përpjekjet për paqe në Rajon kanë një histori të gjatë dhe i ka rrënjët në “Palestinën historike”, që përfshin Izraelin e sotëm, Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës.

Nga ana tjetër, konflikti edhe pse rrotullohet brenda “dimensionit fetar” mbetet një çështje e rrënjësor thellë dhe e shumëanshme, që përfshin çështje të terrorit, refugjatëve, sigurisë, identitetit dhe interesave kombëtare. Me këtë rast, sjellim në vëmendje disa nga ngjarjet peshë nga fundi i shekullit të 19-të - fillimin e shekullit të 20-të:

Siç mund të dihet gjerësisht, në fund të shekullit të 19-të, komunitetet hebraike anëmbanë Europës u përballën me persekutim dhe diskriminim, ndërkohe lëvizja zioniste, e udhëhequr nga Theodor Herzl, u shfaq si projekt për krijimim e një atdheu hebre në Palestinë.

Pas Luftës së Parë Botërore (1947), Kombet e Bashkuara propozuan një plan paqe i cili rekomandonte ndarjen e Palestinës në dy shtete, hebreje dhe arabe, me Jerusalem si qytet ndërkombëtar. Ndërsa udhëheqësit hebrej e pranuan planin, udhëheqësit arabë e refuzuan kategorikisht. Më 14 maj 1948, David Ben-Gurion shpalli themelimin e Shtetit të Izraelit. Të gjitha shtetet arabe, duke përfshirë Egjiptin, Jordaninë, Sirinë dhe Irakun, e kundërshtuan dhe u përfshin në Luftën e Parë Arabo-Izraelite.

(1950-1960): Në vitin 1956, Izraeli, së bashku me Britaninë dhe Francën, pushtuan Egjiptin gjatë krizës së Suezit por presioni ndërkombëtar dhe rrethanat e luftës së ftohtë, i detyroi të tërhiqeshin. Lufta gjashtë ditore (1967): Konflikti 6 ditor midis Izraelit dhe fqinjëve të tij arabë, përfshiu Egjiptin, Jordaninë dhe Sirinë, rezultoi me pushtimin nga Izraeli të Gadishullit Sinai, Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës.

Lufta e Yom Kipurit (1973): Egjipti dhe Siria filluan

OPINION



“Izraeli, e drejta për mbijetesë dhe mbrojtjen e vlerave të qytetërimit”!

një sulm të befasishtëm ndaj Izraelit gjatë festës hebreje të Yom Kipur, por Izraeli jo vetëm e zbrapsi sulmin, por mori edhe më shumë territore. Marrëveshjet e Camp David (1978): të ndërmjetësuar nga SHBA, i normalizuan marrëdhëniet midis Izraelit dhe Egjiptit, i cili u bë vendi i parë arab që njohu Izraelin.

(1987-1993): Protestat dhe kryengritjet palestineze kundër pushtimit izraelit në Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës shënuan Intifadën e Parë. (1993): Negociatat sekrete të Marrëveshjet e Oslos, themeluan Autoritetin Palestinez dhe siguruan një kornizë për vetëqeverisjen në pjesë të Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës.

Përpyqje të tjera, si Samiti i Camp David (2000), Samiti i Tabës (2001) dhe Konferencën e Annapolis (2007), nuk kanë arritur gjithësesi të prodhojnë ndonjë zgjidhje të qëndrueshme në rajon. Marrëveshjet e Abrahamit (2020): Izraeli normalizoi marrëdhëniet me Emiratet e Bashkuara Arabe duke thyer qëndrimin tradicional arab për mosnjohjen e Izraelit pa një zgjidhje për çështjen palestineze.

III.MBI KAPACITETET/FUQINË USHTARAKE SË IZRAELIT (FMI) DHE ORGANIZATËS MILITANTË (TERRORISTE) HAMAS.

Fuqia ushtarake midis Izraelit dhe Hamasit, janë tërësisht të pakrahueshme, pasi Izraeli është një shtet sovran me një ushtri të modernizuar, ndërsa Hamasi është vetëm një organizatë militare/ushtarake. Megjithatë:

Fuqia ushtarake e Izraelit: Ka një forcë të armatosur prej rreth 160-170 mijë forcë aktive (shërbim i detyrueshëm ushtarak) si dhe rreth 500 mijë forcë rezervistë. Forcat e Mbrojtjes së Izraelit (IDF) përbëhen nga forcat tokësore, forcat ajrore, forcat detare si dhe njësi të specializuara.

Ka një industri të avancuar të mbrojtjes dhe merr ndihma dhe mbështetje të konsiderueshme ushtarake nga ShBA. Posedon sisteme të avancuara të armëve, duke përfshirë: Iron Dome, një sistem anti-raketë i krijuar për të kapur dhe asgjësuar raketat dhe predha artilerie si dhe Sistemi Arroë që është një familje raketore anti-balistike; Avionë luftimi të avancuar, duke i dhënë Izraelit epërsi ajrore të pakonkurueshme në rajon. Zotëron po ashtu Tanket Merkava të gjeneratës së fundit, që po i shohim edhe në shtetërrëthimin e shpallur mbas aktit terrorist të 7 Tetorit.

Pavarësisht “dështimit” në këtë rast, Izraeli konsiderohet lider global për kapacitetet Inteligjencës dhe

sigurinë kibernetike, fushë që po bashkëpunon edhe R.Sh, Kosova dhe vendet e tjera të rajonit të Ballkan.

Fuqia ushtarake e Hamasit: Harakat al-Muqaëama al-Islamiya (Levizja e Rezistencës Islamike), themeluar në 1987, organizatë politike & ushtarake (e shpallur terroriste nga ShBA/BE) që kontrollon Rripin e Gazës, pjese e territoreve Palestineze, ka prezencë edhe në Eëst Bank. Aftësitë ushtarake përbëhen kryesisht nga forca të parregullta të inkuadruara në Brigadat Izz ad-Din alQassam. Aktualisht, ka disa mijëra luftëtarë aktivë si dhe mund të rekrutojë një numër më të madh rezervistësh. Është i njohur për rrjetin të gjerë të tuneleve në Gaza, i cili përdoret për kontrabandë dhe sulme të befasishme, si dhe në sulmin terrorist të datës 7 Tetor 2023. Zotëron kryesisht armët të lehta si automatikët dhe mitralozët që përdoren për luftën terroriste dhe guerile, ndërsa eksplozivët, raketat dhe mortajat që përdoren ndaj Izraelit si armë kryesore e shantazhit. Gjithsesi përtej befasisë dhe dështimit në rastin e 7 Tetorit, mbi 85 % e raketave të Hamasit janë kapur dhe asgjësuar nga sistemi i “Kupolës së Hekurt të Izraelit”. Në përmbledhje, kurrësesi Hamasi nuk ka as tiparet, as strukturën e C2; as kapacitete dhe as aftësi për tu krahasuar me fuqinë ushtarake të një komb sovran si Izraeli. Për më tepër, Izraeli ka kapacitete dhe fuqi ushtarake jo vetëm për ta “mposhtur Hamasin” por për t’u përballur dhe dominuar të gjitha vendet Arabe së bashku.

IV. PARIME DHE REKOMANDIME PËR ZGJIDHJEN E KONFLIKTIT DHE RIKTHIMI TE MASAT TË NDËRTIMIT PAQES NË RAJON:

Paraprakisht më duhet të qartësoj fortë se, për sa trajtoj në këtë opinion, kurrësesi nuk kanë të bëjnë me zgjidhje shteruese aq më pak paragjykime mbi sovranitetin territorial, identitetet kombëtare, apo rrënjët e konflikteve mes Izraelit dhe vendeve Arabe. Gjithsesi, po paraqes disa rekomandime për situatën pas dhe përtej rastit të fundit:

A. Për situatën mbas 7 Tetorit: vendet në konflikt, komuniteti ndërkombëtar, NATO/BE, etj duhet ta dënojnë zyrtarisht se pa asnjë hezitim aktin terrorist të 7 Tetorit 2023, në vazhdim akteve kriminale të Hamasit që minojnë bashkëjetesën paqësore mes popujve në rajon dhe kërcënojnë balancat gjeopolitike dhe vlerat e qytetërimit. Për më tepër nuk ma lejon as, grada e lartë ushtarake (gjeneral*) por as eksperiencia në NATO të bëjë “moralizime populiste” mbi detyrimet kushtetuese ndaj Forcave të Armatosura të Izraelit për

mbrojtjen e jetës së qytetarëve, si dhe as më pak ta paragjykojë të drejtën që ka Izraeli të përdorë në mënyrë të përshkallëzuar fuqinë ushtarake (përfshi hakmarrjen shembullore për ta asgjësuar dhe shkukur nga rrënjët Hamasin), për të rivendosur gjendjen në terren si dhe besimin e qytetarëve Izraelit te standardet e sigurisë.

Ndërsa, frymëzuesit dhe terroristët duhet të çohen sa më shpejt të jetë e mundur para drejtësisë Izraelite dhe Gjykatës ndërkombëtare për krime kundër njerëzimit. Sigurisht duhet vetëpërbajtje dhe respektimi konventave ndërkombëtare, duke përdorur arme me precizion të lartë kundër terroristëve, infrastrukturave dhe lidhjeve të Hamasit; duke hapur korridore humanitare dhe mjekësore për popullsinë civile si dhe duke shmangur në maksimumin e mundshëm viktimat të pafajshme (megjithëse në masën 100 % është mision i pamundur).

Thënë këto, në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk do të duhet të ndalen përpjekjet diplomatike nga Izraeli, vendet Arabe dhe komuniteti ndërkombëtar. Më tej për të krijuar frymën e mirëbesimit do duhet një akt falje si dhe një marrëveshje paraprake me faktorët lokal te moderuar që zgjidhjen e konfliktit dhe bashkëjetesën paqësore nuk e shohin kurrësesi nëpërmjet akteve terroriste.

B. Ndërsa përtej aktit terrorist të 7 Tetorit, situata në terren dhe historia e pas-konflikteve na mëson se rruga drejt paqes kërkon përkushtim, kompromis dhe përfshirje të të gjithë faktorëve relevant.

Edhe konflikti izraelito-arab është një çështje komplekse gjeopolitike e shtrirë në dekada dhe që përfshin një mori faktorësh historikë, fetarë, kulturore, territorialë, identitetin kombëtar, interesa ekonomike, etj. Prandaj, një zgjidhje e qëndrueshme përfshin adresimin e ktyre faktorëve dhe sigurisht do duhet të prevalojnë mekanizmat diplomatike mes Izraelit, Palestinës dhe vendeve të tjera. Një opsion i diskutuar gjerësisht si zgjidhje është krijimi i dy shteteve sovraane, Izraelit dhe Palestinës, që do të përfshinte negociatat për kufijtë, refugjatët dhe Jerusalemi si kryeqytet i përbashkët për të dy vendet sovraane. Bashkë me këtë, adresimi i çështjes së refugjatëve palestinezë, përmes kompensimit, zhvendosjes ose kthimit sipas kushteve të dakorduara paraprakisht. Masat e mirëbesimit reciprok përfshijnë de-militarizimin, balancat e fuqisë ushtarake dhe garancitë e sigurisë për Izraelin, liri i të burgosurve, bashkëpunimi ekonomik dhe shkëmbimet kulturore. Sigurisht, aktorët ndërkombëtarë, OKB, ShBA, BE si dhe ata rajonale, kanë një rol thelbësor në suksesin e negociatave për paqe të qëndrueshme.

V. NË SHITESË, si në çdo dhjetëra vlerësime me peshë në fushën e sigurisë, dëshiroj që edhe këtë artikull ta përmbyll me “impakte dhe rekomandime strategjike” për faktorët dhe aktorët në Tiranë dhe Prishtinë zyrtare:

Patjetër që gjëj paralele dhe impakte mbi interesat mbarëkombëtare, pasi sulmi terrorist i Hamasit ndodhi jo rastësisht vetëm 2 javë mbas aktit terrorist, që bandat mercenare të frymëzuara nga oshilacionet e Ministrisë të Millosheviçit dhe interesat e Rusisë-Putiniste, ndërmorën ndaj Kosovës.

Gjithashtu dua ta përsëris se “jo për meritë të protagonistëve të mbi-pushtetshëm, që mjerisht as rezolutën të përbashkët (në letër) mes dy Kuvendeve nuk mundën të realizojnë”, por falë gjakut të dëshmorit të kombit Afrim Bunjaku dhe profesionalizmit elitare të FSK si dhe mbështetjes së aleatëve strategjik

(USA/NATO), Kosova fitoi një betejë historike: “duke shmangur një skenar të Krimesë për t’i kthyer manastiret e Kosovës në depo armësh, bunkerë terroristesh dhe barikada të civilëve te pafajshëm”!

Nuk mund të mos shpreh neverinë ndaj një përpjekje për të baraz(sh)vlerësuar përpjekjet e çlirimtarëve të Kosovës me ato të grupit terrorist të Hamasit! Përtej “revoltës patriotike”, përgjigja është e vërteta, që: “në asnjë rast të vetëm nuk janë goditur popullsia e pafajshme; kurrë nuk janë marrë pengje fëmijë, pleq, gra apo vajza Serbe”. Përkundrazi, projekti i shenjtorit Rugova privaloi dhe me ndërhyrjen legjitime të NATOs Kosova u çlirua nga pushtuesit Serb.

Thënë këto, Tirana dhe Prishtina zyrtare do duhet të konfirmojnë solidaritetin dhe mbështetje të pakushtëzuar për Izraelin jo vetëm për shkak të lidhjeve

PROFILI

“Vajzë labe/ bijë malsie/ luftove si të kish hije !”

Zonja Çurre: S’kemi ç’presim më, ore shokë!

Nga Neki ÇAKO


Tek po kaloj në një nga rrugët e Tiranës, e pikërisht në atë që mban emërtimin e heroinës së popullit “Zonja Çurre” me vjen ndër mënd një shprehje e saj e përdorur gjatë luftës, të cilën e kam lexuar diku në një libër që flet për jetën e kësaj Heroine. “S’kemi ç’presim më ore shokë!”

Nuk di nëse do të ishte amaneti i saj që sot në Tiranë një rrugë që mban emrin e kësaj Heroine të jetë në një gjëndje kaq të mjerueshme, akoma me keq se në vitin 1942. A do ta pranonte vetë heroina këtë gjëndje! A mos vallë të jetë kjo vërtetë një nga ato harresat që u bëhen heronjve, dëshmorëve, veteranëve, apo pasardhësve të tyre që emërtimet të jenë kaq të padukshme dhe rrugët të mos jenë ashtu si ata i dëshironin, për të cilën dhanë gjakun e tyre në moshë fare të re për aspiratat që ata kishin, për ta parë Atdheun të begatë. A është vërtetë realizimi i ëndërrave të tyre liria, që gëzojmë ne sot! Mirëpo, sot ne ndodhemi në vitin 2023. Le të sjellim pjesë nga jeta e kësaj heroine dhe mbase kushedi, ky shkrim troket në ndonjë derë që ka përgjegjësi për rikostruksionin e këtyre tabelave dhe rrugëve për të nxjerrë në pah aspiratat e heronjve, për t’i bërë realitet ëndërrat e tyre.

Tradhëtarë nuk keni vënd ku të futeni nga pushka partizane! Unë kam ardhur të qëndroj me shokët e mi të luftës. Dua të luftoj bashkë me ta, të marr pjesë në ç’do aksion dhe të hakmrrrem mbi pushtuesin dhe tradhëtarët. Kurrë nuk do ti harroj porositë e Hazbiut, Lilos dhe Kujtimin që më thanë kur u ndava prej tyre në malin me dëborë të Dukatit. Nuk i harroj vuajtjet dhe këmbët e tyre të zbathura e të enjtura, duart e tyre të gjakosura dhe fytyrën e tyre të njomë të jeshilosur nga vuajtjet e rrugës. Nuk harroj plagët e shokëve dhe gjakun që u rridhte lumë në shpatullat e mia në qafen e Shëngjergjit. Jo, shoku komisar dua të luftoj! (fjalë të heroinës kur i kërkohej të shtrohej në spital). Zonja Çurre lindi në Tragjas të Vlorës, më, 1920 në një familje të thjeshtë dhe shumë të varfër. Vdekja është më e ëmbël se robëria, thoshte shpesh ajo! Ndjeu urrejtje të madhe ndaj pushtuesëve fashistë! Kur do ti hedhim në det këta të lanetisurqë kanë lënë atdheun e tyre. Dhe koha erdhi! Anë e mbanë Shqipërisë filluan të mblidhen njësitet e para guerile. U formuan çetat e para partizane. Ne rrethin e Vlores u formuan disa çeta partizane. Sa e afërt tregohej Zonja Çurre me ta ,bëhej njësh me luftëtarët e lirisë. Ajo jo vetëm, i simpatizonte ata, por u vinte edhe në ndihmë. Ajo i priste e përcillte, duke u siguruar armë e municion dhe veshmbathje. Zonja u zgjodh anëtare e rinisë komuniste në Tragjas. Me fillimet e vitit 1943 ajo do të linte mënjatë hallet dhe do ti bashkohej



çështjes për çlirim. Vajza me shtat vigan, me një fytyrë të bukur prej një labeje, me flokë të derdhura e me syrin pishë mësoi me kureshtje, duke u bërë snajpere, e zonja e mitralozit. Asaj ju caktua detyra e skuadër-komandantes. Edhe pas marrjes së këtij roli ajo nuk i ndahej shpirti nga mitralozit. U rreshtua në brigade e



5 sulmuese dhe nuk u nda prej saj duke marrë detyra të njëpasnjëshme, edhe pse kushtet ishin ende shumë të veshtira, e plot rreziqe, pa veshëmbathje, ushqim dhe pagjumësi. Gjatë një lufte të përgjakshme kompania e saj ngeli e rrethuar në Himarë. Koha nuk priste. Rrethimi duhej çarë. Përgjegjësia ishte e madhe dhe shokët që ishin me të ishin në moshë fare të re. Moti ishte i keq dhe dëbora kishte rritur trashësinë dhe mezi mundën të kalonin edhe pse të sflitur. Ajo u detyrua ti marrë shokët në krahë duke u zarritur për të kaluar ato shtigje të ngushta, e për të mos rënë në dorën e pushtesve. Ajo e vetme mundi të mbrijë deri në Tragjas, ashtu e raskapitur, por ra pa ndjenja duke belbëzuar. Me fjalë nëpër dhembë tha: - shkoni shpëtoni shokët, janë në mal në dëborë dhe u këput pa ndjenja. Komanda e batalionit e porositi Zonjën që të qëndronte disa ditë në spital që të merrte veten, deri sa të shërohej plotësisht, por ajo nuk pranoi një gjë të tillë. Jo nuk mund të rri s’kam gjë edhe pse këmbët i kishte të enjtura e me zor lëvizte, ajo u çua dhe u bashkua me batalionin. Asaj, ju besua detyra e zv/ komandantes së kompanisë. Shtabi i brigadës kishte besim tek Zonja. Ajo mësynte e para. Nuk ishte vetëm një trimëreshë, por edhe një agjitatore e flaktë. Ajo trumbetonte luftën si të vetmen forcë për çlirim e shpëtim. Në 11 korrik 1944 në një përpjekje të ashpër me pushtuesit, në Qafë Shkallë (Klos) në rrethin e Matit. Ndonëse e plagosur rëndë ajo luftoi pa pushim. Mitralozit i saj po korrte forcat pushtuese. Zëri i saj ushtonte. Para partizanë. Përpara shokë....!!!! Ndërsa një plumb i mallkuar ja mori jetën. Vetmohimin e saj, populli i asaj treve e përjetësoi në këngë, e cila u këndua brez pas brezi deri në ditët e sotme si një himn, frymëzimi për ne dhe gjithë brezat që do të vijjnë:

“Vajzë labe/ Bijë malsie/ Luftove si të kish hije !
Meraku i nënës.



Si ç’do prind merakut ishte i pranishëm kudo, në ç’do hap të saj. Ndërsa e ëma e vetë, regon se vajza e saj Zonja, i thoshte se nuk ishte vetëm në luftë, por mbante edhe dy shokë të pa ndarë. Një natë Zonja nisete në çetë, ndërkohë që sa kishte errësuar, kurse moti ishte i keq. Nëna e ndalon dhe i thotë: - Si mund të shkosh e vetëm në çetë, pa pasur një shok, rri sa të zbardhi dita dhe nisu! Ajo edhe pse ishte duke nxituar ju përgjigj. Nuk jam vetëm, jo! I kam edhe dy shokë të fuqishëm me vete. Dy shokë të fortë! Po ku janë sillit që t’i shoh: - i thoshte nëna gjithë merak, nga frika se mos e gënjete. Ja ku janë! Zonja kishte nxjerrë nga xhaketa dy bomba të cilat i mbante me kujdes në duar. E shikon tani që nuk jam vetëm! Dhe sa hap e mbyll sytë u largua. E bëra këtë përshkrim sepse ne kujtohemi të shkruajmë për ta vetëm në datat e lindjes apo në kujtim përvjetorësh duke e ditur se njeriu vdes kur ai harrohet së kujtuari. Të gjithë duhet të kujtohemi që të bashkuar mund të punojmë që të ruajmë vlerat patriotike, sakrificat e tyre sublime, amanetin e tyre ta çojmë deri në fund duke ruajtur të pa përlyer gjakun e tyre për ta bërë vëndin ashtu si ata e dëshironin

“Izraeli, e drejta për mbijetesë dhe mbrojtjen e vlerave të qytetërimit”!

(Vijon nga faqja 11)

historike dhe reciprocitetit të mirënjohjes që ka Izraelit ndaj kombit tonë për shpëtimin e Hebrejve nga nazistët gjatë Luftës II-të botërore, por edhe për tu rreshtuar pa kompromis krah ShBA-ve (aleate strategjike e Izraelit) që ka luajtur rol përcaktues jo vetëm për çlirimin dhe faktorizimin gjeopolitik të Kosovës, por edhe specifikisht për njohjen si “surprizë e mençur” në dhomën ovale (në kuadër të Projektit të Presidentit Trump) nga Izraeli në kuadër të paketës 12 miliard €, përfshi autostradën e paqes, linjën hekurudhore, portin në ujërat e thella të Adriatikut, etj.

Ndërsa e risjellë në kontekstin e interesave gjeopolitike, kombi ynë ka arsye të forta ndërsa autoritetet shtetërore e kanë detyrim shtetëror jo vetëm të “vendosin numër telefoni për të ndihmuar bashkëqytet-

arët Shqiptare për transportin nga zonat e konfliktit” por dhe të dënojnë “me një zë të përbashkët” terrorizmin si dhe të mbështesin përpjekjet e Izraelit në këtë betejë me të keqen e përbashkët/terrorizmin.

Në përmbyllje përsëris se “përtej luftës, paqja mbetet mision i vështirë por opsioni i vetëm”. Kështu jam besimplotë se Izraeli jo vetëm do t’i ndëshkojë në mënyrë shembullore terroristet por paqja dhe vlerat e qytetërimit do të triumfojnë mbi terroristet e Hamasit, Rusinë-Putiniste, Kim-Jong-un, Iranin dhe ndaj çdo mendje tjetër të deformuar në botë.

*Ekspert për SK, Rajonin & NATO,
Zv/President i Këshillit të Atlantikut,
Anëtar i Bordit “Israel House”, si dhe Ish:
Këshilltar Ushtarak i Presidentit të R.Sh;
Përfaqësues Kombëtar në SHAPE/NATO.

SPECIALE

KUR ABDURRAHIM BUZA PUTHI NË PUKË FLAMURIN KOMBËTAR SHQIPTAR



Xhemal Meçi
Studiues, "Mjeshër i Madh"

Për vazhdimin e qëndrimit në Pukë, bashkë me Bijë Vokshin e Fehmije Buza në ato dy ditë me ngjarje interesante pranë Familjes së mirënjohur NUSHI ia vlen të vazhdohet në një shkrim tjetër



Prindërit e kishin frymëzuar me atë për liri Kombëtare; por Lufta Ballkanike S e vitit 1913, kryesisht e drejtuar kundër Shqiptarëve, i solli tragjedi familjare, si mijëra kosovarëve të tjerë, duke mbetur edhe ky jetim në moshën 8-vjeçare. I mjeruar e pa shpresë, më në fund gjeti dashuri e përkrahje te dajat në Shkup, të cilët i ndërhyjnë Bajram Beg Currit, Hero i Popullit, që ta dërgonin, simbas dëshirës së Tij, në shkollë, në Shkodër, Konvikti "Malet Tona", i sapokijuar. Por historia e dhimbëshme e Shkodrës së rrethuar dhe bombarduar barbarisht nga ushtritë pushtuese serbo-malazeze 7 muaj më 1913, i la mbresa të paharrueshme. Por kujdesi i personelit d, si dhe jeta e gjallë e nxënëseve atij konvikti ia pakësuan dhimbjen dhe e nxitën që t' u përvishej mësimëve, aq sa filloi të dallohej midis shokëve, duke fituar edhe mirënjohjen e personelit të konviktit, Kështu përkrahet që mësimet e para t'i plotësoi në Tiranë dhe në Normalen e Elbasanit, ku tregoi vullnet, urtësi dhe talent në pikturë, prandaj më 1928 fiton bursë shtetërore për studime të larta në Itali. Fillimisht qëndroi si dëgjues në Akademinë e Arteve të Bukura në Torino. Studimet e rregullta i kreu në Akademinë e Arteve të Bukura në Firence pranë artistit të mirënjohur Galeleo Kinit. Tani pas 5 vitesh të suksesshme arti në pikturë, më 1933 kthehet në Tiranë, në Atdheun e Tij

të dashur, por thellë në shpirt shprehte herë-herë një pikëllim për shpëputjen nga vendlindja e Tij, Gjakovë e Shkup, bashkë me Kosovën e Dashur, e dënuar nga Konferenca e Fuqive të Mëdha në Londër, 1913, për të qëndruar nën terrorin e pandërprerë Serb të Mbretërisë Jugosllave. Por dëshpërimin që ndjente e shprehte me një vullnet plot përkushtim në pikturat e Tij, duke e shndëruar artin në simbolikë të lartë me motive etnike që nga Gjakova, Kosova, Veriu i Shqipërisë, dhe në vazhdim mbarë kombëtare, të cilat bëhen subjekt i shpeshtë i krijimtarisë së tij si: REFUGJATËT, 1957, AZEM GALICA, 1976, QËNDISJA E FLAMURIT, 1979, KUVENDI I LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT, 1978 etj. Prej veprave të Tij sot ruhen 500 tablo të realizuara në vaj dhe 10 - mijë vizatime.

Për meritat e Tij në krijimtari dhe punë arsimore, sherbeu deri në pension, si pedagog i vizatimit dhe N/Drejtor i Liceut Artistik "Jordan Misja" Tiranë, ku,

nderohet me dekoratat e larta: "MËSUES I Popullit", "Piktori i Merituar" dhe "Piktori i Popullit".


ABDURRAHIM BUZA DY HERË NË PUKË (1922, 1975)

Gjatë fillimeve të viteve 1970 Fehmije Buza, kushëriri e afër me Abdurrahim Buza erdhi dy herë në Tiranë, e cila i kërkoi Piktorit që të vinin në Pukë te Familja Nushi (imam Qazim Nushi dhe Shyhreti Canhasi, Nushi Gjakovar. Shyhreti e Fehmija ishin bija tezeshe, nënat motra). Vëllezërit Canhasi (Miniri dhe Minibi) dy herë kishin dërguar në Tiranë Fletëgarancinë Familjes Nushi për në vizitë në Gjakovë, vendlinjen e tyre, por pa rezultat. Tani ishte në Tiranë edhe Bijë Vokshi, halla e Hasim Vokshit, Hero i Popullit. Bijë Vokshi kishte lidhje familjare me Qazim Nushin, sepse Nëna e Qazim Nushit; ZYLHAJA ishte mbesa e Sulejman VOKSHIT. Për më tepër, e nderuara Bijë Vokshi i kishte edhe një detyrim moral Minir Canhasit, (të vëllajt të Shyhretit) i cili e kishte strehuar në baza të sigurta gjatë vitit 1944, kur ndiqei për burgim nga gestapoja gjermane. Prandaj Bijë Vokshi pranoi megjithë qejf të vinte në Pukë. Kështu që një ditë të bukur qershori të vitit 1975 zbankuan që të tre (Piktori, Bija e Fehmija) në Pukë te familja e gëzuar NUSHI. Unë si dhëndëri i familjes, i martuar me vajzën e madhe të Nushve, të mirënjohurën Nexhmije Qazim Nushi, arsimtare me arsim të lartë Pedagogjik (Gjuhë Letërsi shqipe, si edhe unë) qëndroja në këmbë i gatshëm për çdo gjë që t' ju shërbeja e t'u hija në qejf, se isha me origjinë nga fshati, katundar hesapi, dhe me një farë problemi biografije. Sabria, motra e tretë e Nexhmijes kishte filluar në Tiranë Akademinë e Arteve të Bukura, Institutin e Lartë të Arteve për muzikë, të cilin e përfundoi shkëlqyeshëm; kurse Hidij Pukës gjatë udhëtimit për në Shkodër, përballë nesh u shfaq posta e xhandarmërisë, mbi një kodrinë pak të ngritur mbi shesh, ku tani, qenka ndërtohet Pallati i Kulturës. Përballë atij sheshi ngrihej FLAMURI kombëtar Shqiptar!!! Fare afër i qëndronte në pozicion gaditu roja, një malësor trupmadh me armën në dorë. Unë pa një e pa dy iu sula Flamurit për ta puthur, por roja më thirri kërcënueshëm: "Ndal, mos guxo e cenon FLAMURIN!!!" Unë u shtanga në

vend, tuj i thanë me ngashërim: "Mos burre shqiptar! Mos më pengo ta puthi FLAMURIN, për të cilin po pritët e digjet mbarë KOSOVA!! Kështu tuj folë e tuj iu afrue flamurit derisa e arrita dhe fillova ta puthja me aq afsh sikur po hakmarresha për prindërit e mi e mbarë Dëshmorët e ramë për LIRI e PAVARËSI! Roja sikur u përmallua, ndërsa tha si me dashamirësi: " Hajde, mor djalë trim Kosovar e puthe sa të duesh FLAMURIN tonë Kombëtar Shqiptar, por të bërtita, se Gjon Marka Gjoni ka shpallë në Prizren "Republikën e Mirditës" dhe na ka kërcënuar që ose t'i bashkohna "Republikës së Tij të Mirditës" me të mirë, ose do të na bashkoi me forcë dhe të na heq FLAMURIN e Republikës Shqiptare! Po Puka asht kundra ndamjes në pñcipata, fise e republika krahinore! Po ti hajde tash, të puthemi e të rrokemi si vëllazën që jemi! Prandaj, më falë për mënyren si u solla. Me kaq sikur u miqësuem, por PUTHJA E FLAMURIT Kombëtar në PUKË më ka mbetur si një nga




Piktori i Popullit - ABDURRAHIM BUZA në studion e tij



QENDISJA E FLAMURIT

(voj. 1979)



AZEM GALICA ÇAN RRETHIMIN

(voj. 1979)

kujtimet kryesore të jetës sime, se e kujtoj veten si Isa Boletini që puthi Flamurin në Vlorë, sapo ia solla Ismail Qemali! Sa herë them me vete: " Hajde, Abdurrahim, hajde, që e Puthe Flamurin Kombëtar në PUKË, si Isa Boletini në VLORË! Ai në Jug e ti në Veri sa mbete në Histori!!!

Edhe përrallat përsëriten

Cfarë tregon, se jo vetëm historitë por edhe përrallat përsëriten, veçanërisht kur ato janë tërheqëse si të Hirushes, që martohet me Princin e Kaltër

Nga Merlin Tushe
New York, Tetor 2023

Këto ditë në shkallët e Pallatit Mbretëror në Danimarkë, rojet e Pallatit gjetën një këpucë të shëndritshme, që sigurisht i përkiste ndonjë vajze të re. Në fakt ishte sandale me takë e me rripa, që patjetër ishte e këmbës së majtë të një "Hirushë-je". Por si ndodhi që, kjo ngjarje të përsëritet duke i përngjarë përrallës së bukur të vëllezërve Grimm. Djali i madh i i Princit të Kurorës në Danimarkë - Frederikut dhe Princeshës Maria, i quajtur Princi Christian në muajin Tetor mbushi 18 vjeç. Të gjithë u gëzuan, gjyshja Margarethe gjithashtu, të cilët organizuan një mbrëmje madhështore në Pallatin Mbretëror. U luajt muzikë, valle dhe u servirën ushqime të bollshme. Për nder të trashëgimtarit mbretëror të Danimarkës - Princit Christian, u ftuan shumë miq, princër e princesha nga e gjithë bota, me tyre morën pjesë edhe Princi e Princesha e Hollandës, Belgjikës, Norvegjisë, Suedisë etj. Të gjithë kërcyen e u argëtuan shtëpërimi, ku binin në sy vajzat e reja veshur me fustane të gjatë me flutura në ngjyrat e ylberit. Mbrëmja gala u mbyll me një koncert festiv. Pasi u larguan edhe të ftuarit e fundit, rojet gjetën në shkallët e Pallatit Mbretëror sandalen e shëndritshme. Por nuk e dinin e nuk e dinë akoma se e kujt është ajo....

Vajzës bukuroshe (si duket) nga nxitimi për t'u larguar sa më parë nga Pallati Mbretëror, i kishte ngecur sandalja tek fustani i gjatë e gati s'ishte "trëzuar". E mira për të ishte të linte sandalen në tapetin e kuq e të largohej pa u venë re, emri i të cilës nuk njihet akoma. Ose si Hirushja e përrallës së dashur për fëmijë, pasi kishte hyrë në Pallat me maskë pa u pikasur nga njeri, kishte kërcyer e lumtur në Pallatin e Endrrave, por duke u larguar "pa dashur" kishte harruar tek shkallët e Pallatit Mbretëror këpucën e saj të shëndritshme. Princi Christian dhe Pallati Mbretëror janë duke e kërkuar. Edhe në shpresojmë ta gjejmë Hirushen e bukur ose Cinderellen, cfarë tregon se jo vetëm historia, por edhe përrallat përsëriten. Veçanërisht kur ato janë tërheqëse, si të Hirushes që martohet me Princin e Kaltër.

SUPLEMENTI LETRAT



Nga Kadri Tarelli

DY VEPRIMTARI NË NJË DITË

Art dhe letërsi bashkë

Nga OBVL në bashkëpunim me Bibliotekën Publike të qytetit, u përurua libri "VUAJTJA E QYTETIT, Shkodra", me autor Mark Zadeja, anëtar i Akademisë Evropiane

mësuar në të gjitha shkrimet e kësaj tematike.

Autori nuk merret me këtë lloj letërsie. Sepse sot, të gjithë i dinë këto, pasi ka 30 vjet që është shkruar dhe vazhdon të shkruhet, prandaj

dhe të shkruarit, madje kërkohet edhe një nivel i lartë edhe i lexuesit.

Kam ndjesi se duke dëgjuar këto fjalë, cilitdo nga ne i lind e drejta të mendojë e të gjykojë, se ky libër është i vështirë për t'u lexuar e kuptuar.

Pushtetarët kriminelë, i varfërojnë popujt e tyre aq shumë, në mënyrë që ata të kalojnë gjithë kohën për të siguruar bukën e gojës dhe të mos u mbetet më kohë për t'u hedhur në revoltë".

Aristoteli



Në qytetin e Durrësit, në galerinë e artit pamor "Nikolet Vasia", më 17, të vjeshtës së dytë, 2023, në prani të shumë qytetarëve artdashës durrsak, u hap ekspozita e një grupi piktorësh, me simbolikën "Pëllumbat e PAQES", ku kryesues ishte artisti i njohur Jetullah Haliti, artisti i ri Blendi Zogaj dhe të tjerë nga hapësirat mbarë-shqiptare, të cilët na sollën tablo e punime, ku shprehej nëpërmjet ngjyrave, poezia e shpirtit, dëshira e popullit dhe e kombit shqiptar, për paqe e ringritje shpirtërore.

Një orë më pas, në sallën "Odeon", në mjediset e Pallatit të Kulturës "A. Moisiu", të qytetit të Durrësit, nga OBVL në bashkëpunim me Bibliotekën Publike të qytetit, u përurua libri "VUAJTJA E QYTETIT, Shkodra", me autor Mark Zadeja, anëtar i Akademisë Evropiane

Në këtë kuvend libri, në prani të shumë qytetarëve dhe intelektualëve të Durrësit, së bashku me artistët piktorë nga Dardania, përshëndetën: Shpendi Topollaj, Fatmir Minguli, Arben Kristani, Jetullah Haliti, Merita Kuç-Thartori, Myzejen Konduri, etj.

Me këtë rast edhe unë Kadri Tarelli, munda të jap vlerësimin tim për këtë vepër të rrallë, me peshë të madhe në mendimin historik e filozofik shqiptar. Shkrimin tim e titullova:

"VUAJTJA E QYTETIT, SI HISTORII, PSIKOLOGJI DHE FILOZOFI"

Kujtesa, heshtja, humori dhe e qeshura, që mbajti gjallë një qytet

Në vështrim të parë, duke lexuar titullin: "Vuajtja e qytetit. Shkodra", mendova se me këtë libër do të pasuroj dijen time me vuajtjet e qytetarëve shkodran, si rrëfime të pa njohura më parë. Madje me vete thashë: "Përsëri do të futem në përjetim të atyre ngjarjeve që kanë fillim, por jo fund, ngjarje plot vuajtje e dhimbje njerëzore, të ndodhura e të shkaktuara çuditërisht jo nga pushtuesi, por me shqiptarët nga shqiptarët.

Isha i gabuar. Ky libër i vogël në dukje, përcjell vuajtjet e dhimbjet njerëzore të një qyteti, jo konkretisht në formë klasike (rrëfim apo kujtim të përjetuar në kohë dhe vend, me personazh vuajtës dhe xhelat, siç jemi

Marku nuk rri t'i numërojë ato. Kanë shkruar për to, pena të shquara të letrave shqipe: Arshi Pipa, At Zef Pllumi, Uran Kalakula, Visar Zhiti, Fatos Lubonja, Pjetër Arbnori, Spartak Ngjela, Maks Velo e plot të tjerë, të burgosur të ndërgjegjes ose fare pa faj, që me rrëfimet e tyre të trishta e plot dhimbje, kanë sjellë të gjallë atë pjesë të shëmtuar, të nëmur e të mallkuar të historisë shqiptare, që na dhemb, na tmerron dhe na turpëron njëherazi, duke pyetur veten: Pse...Pse pse? Pa kërkuar përgjigje, të cilën e mban gjallë heshtja dhe kujtesa.

Autor Marku, nga ana e tij, gjen një formë të re, të pa ndeshur më parë, të paktën nga unë si lexues i hershëm. Ai bën zbërthimin shpirtëror, zbulon fenomenet që ngjasin në ndërgjegjen e tij dhe të bashkëqytetarëve, studion deri ku të çon durimi dhe si mundet që njeriu para këtyre llahtarive të mbetet përsëri njeri dhe qytetar. Ai, më konkretisht, merret me dukurinë e kujtesës individuale e kolektive, si proces mendor e më pak fizik, duke e trajtuar në ndjesitë psikologjike, më pas të përgjithësuar në mendim historik e filozofik. Diçka vërtet për t'u përgëzuar e admiruar.

Besoj se jam i saktë, se në rastin e parë, libra të tillë vlerësohen nga mjeshtrëria e shkrimtarit për të rrëfyer bukur artistikisht, ndërsa në këtë libër, duhet një njohje e thellë në fushën e psikologjisë individuale dhe kolektive, për të hyrë në thelb të çështjes. Pra një shkallë e lartë e të menduarit

Mendoj se gabohet, pasi është shkruar më gjuhë e fjalor të thjeshtë, të kuptueshëm nga të gjithë, pa fjalë të mëdha, apo të ngjeshura me fjalë "të jashtme". I vështirë është si të rrokët e përthithet mendimi në rrafshin e një analize teorike, njëherazi edhe praktike. Bie fjala: si përjetohet e përballohet vuajtja e mbarë qytetit, si durohet durimi, poshtërimi dhe mjerimi! Si përcillet dhunimi, pushkatimi, internimi, heshtja dhe pikëllimi, jo për një apo pak individë të thjeshtë apo të shumë njohur si personalitete të qytetit, jo një herë, apo një ditë, por në vazhdimësi me dekada, duke i mbështjellë me shpresën dhe zhgënjimin, jo thjesht për të mbijetuar por për të rilindur e ringritur.

Përfundimi: Dhe, qyteti mbijetoi falë kujtesës, si fillim, heshtjes si durim dhe shkrimit në vazhdim. Ah heshtja.... Ky thesar mbrojtës i trupit dhe shpirtit. Heshtja, kujtesa dhe humori, armët më të fuqishme të qytetit dhe qytetarëve për të mbijetuar dhe rilindur. Këtu nuk them gjë të re për lexuesin, që e njeh sado pak Shkodrën dhe shkodranët, që dhimbjen e përthypnin dhe e gëlltisin përherë me buzëqeshje, por shoqëruar me humor të hidhur, që shponte sistemin, por mbante gjallë një shpirt të trazuar e të mbushur me mllef për diktaturën dhe shërbëtorët e saj. Qyteti përqeshte dhe tallte diktaturën, që nuk ngopej me persekutimin dhe hakmarrjen ndaj një qyteti, nga më të bukurit, më të diturit, më të qeshurit, që përherë

rrezatonte kulturë dhe art të mirëfilltë. Në ende mbajmë në kujtesë barcaletat me theks politik të shkodranëve, që i përsërisim duke u gajatur së qeshuri, edhe sot pas kaq vjetësh. Çudi..... të mbijetosh vetëm duke qeshur...!?

Nuk është e vështirë të kuptohet, se libri fillon me "Murrin e gjakut", pra Shkodra në prag-fundi i vitit 1944 dhe fillim i vitit 1945, kur fjala pushkatim ishte bërë e zakonshme, ndërsa vuajtja përjetohej me lot dhe heshtje. Kështu me radhë, historia vazhdon edhe me ngjarje, që kanë lënë gjurmë në historinë e qytetit dhe mbarë Shqipërisë, duke mos kursyer dukuri edhe të ditëve tona. Bie fjala "letërsia e realizmit socialist", ose "Revolta e Spaçit", ndërkaq edhe në ditët e sotme, korrupsioni në administratë e deri te mjeku..... Etj, etj.

Si zakoni i imi, nuk merrem me analizë të përmbajtjes. Atë e lexon, e njeh dhe e gjykon vetë lexuesi. Pa përmendur poezitë, thurur nga vetë autori, si përjetim dhe përforcim i vuajtjes dhe dhimbjes: Ja disa tituj: "Mbas vorrezës": "Kufomat ngrihen sodisin, / mbas vorrezës, te muri i gjakut...", "Muri i gjakut", "Dom Ndre Zadejes", "Luftë klasash"..... nata kërkon të vrasë/ jetë e zhgënjyeme, luftë klasash/ prej shpirtit të hanës kullon loti.....", "Qyteti im-Gravurë e përjetshme", etj, etj.

Veç dua të shtoj diçka që e vlen të thuhet: Shprehje dhe fjali që bartin men-

(Vijon në faqen 15)

SUPLEMENTI LETRAT

TË DREJTAT DHE KËRKESAT E POPULLSISË ÇAME DUHEN MBROJTUR ME ÇDO KUSHT

Pse çështja çame nuk ekziston për qeverinë tonë ?



SHPENDI TOPOLLAJ

Libri i profesor Selman Shemes “Çështja çame, perspektiva e zgjidhjes, perspektivë e integritetit”, në një farë kuptimi është zgjatim i librit të tij të mëparshëm dhe shumë të mirëpritur “Vendbanimet në hapësirën historike shqiptare të Çamërisë”. Nuk e di sesa jehona e këtij të fundit, me arsyetimet shkencore dhe të vërtetat që përmbante, ka mbërritur në veshët e politikanëve tanë. Por e di se po kalojmë një kohë të çuditshme e cila sepse më sjell ndërmend atë çka Nikollaj Vasiljeviç Gogoli qysh në shek. e 19 - të përshkruante te “Shënimet e një të çmenduri”, se dëshira e një fisniku për t’u ngritur në rangun e të tjerëve, dëshirë që po e torturonte, e shtyn të nxjerrë mllëfin për ta duke u shprehur: “Vështroni gjithë këta nëpunës të lartë, këta të gjithë i bëjnë lajka njëri - tjetrit, shtyhen të hyjnë në pallat dhe thonë se janë patriotë. Gjithë këta njerëz, këta patriotë, nuk duan gjë tjetër, veçse para! Për para janë gati të shesin nënën, babanë, perëndinë”. Por këta “fisnikët” tanë ua kanë kaluar edhe atyre, pasi nuk e kanë për gjë të shesin edhe Atdheun, duke tjuar teorinë e patriotizmit folklorik.

Pra, thënë më shqip: jeni të tejkaluar, dhe duke folur për çështjen kombëtare, po dëmtoni imazhin tonë properëndimor dhe euroatlantik. A thua se këta perëndimorët vetë po zbatojnë parimin e Mark Tul Ciceronit “Ubi bene, ibi patria” që do të thotë se “Ku është mirë

është Atdheu”. Jo mor jo, ata e kanë të shenjtë vendin e tyre dhe gjithçka lidhet me të. Por nuk para bëhen merak për të ndequr sa mundet padrejtësitë që të parët e tyre u kanë bërë vendeve të tjera. Dhe ndofta ajo më flagranta dhe më e turpshme është ajo që i është bërë me gjakftohtësi dhe konshiençë të plotë qysh para 110 vjetësh Shqipërisë, duke e ndarë në gjashtë copa. Asnjëherë, në kançelaritë evropiane nuk është diskutuar ky problem. Dhe ata nuk ka pse t’i vrasë sado pak ndërgjegjia, kur për këtë çështje nuk flasin vetë shqiptarët. Se ju e keni parë; ne jemi shumë të preokupuar për të tjerët, kurse bashkimin e trojeve tona, ua kemi lënë brezave pasardhës.

Mirë ata “fisnikët” mediokër e puthadorë të politikës, po intelektualët ku janë dhe pse heshtin? Si mund të mos u bëjë përshtypje atyre qëndrimi arrogant ndaj Kosovës e shërrret me udhëheqësit e saj, deri në profeci Kasandre se do të ketë reperkursione po nuk krijuan asociacionet djallëzore, dhe shpërfillja e Çamërisë të martirizuar? Memeclëkun e polikanëve për t’i ngritur këto çështje politikisht e diplomatikisht, qoftë edhe nëpër forume ndërkombëtare, duhet ta kompensojnë ata, pasi gjithkush ka përgjegjësitë e veta për t’i dalë Atdheut për zot. Dhe ja, shembullin tek e kemi; te përpjekjet e pareshtura të Prof. dr. Selman Shemes, autorit të një mori monografishë dhe artikujve studimorë, pa folur për ligjeratat e argumentuara që pa drojë mban në shumë vende të botës deri në SHBA.

Natyrisht që ka edhe të tjerë si Shaban Murati, Engjell Musai, Mujë Bucpapaj, Genc Burimi, Fatos Lubonja, Ksenofon Kristafi, Dashamir Uruçi, Resmi Osmani, Halil Rama, biri i Kavajës Xhevat Mustafa etj. por Selmani i ka hyrë në themel asaj, pra Çamërisë, që i madhi Ismail Kadare e quan jo fantazmë për të errësuar marrëdhëniet e fqinjësisë midis grekëve dhe shqiptarëve, por si arsye për ta lehtësuar ndërgjegjen nga peshat e vjetra, për t’u afruar më fort dy popujt dhe për ta dashur edhe më shumë njëri - tjetrin. Prof. Selmani në këtë libër përshkruan në kapituj të veçantë prejardhjen pellazgo - ilire, shtrirjen gjeografike të Çamërisë qysh nga kohët e lashta, gjetjet arkeologjike dhe tipologjinë shqiptare në mjediset e banimit në Çamëri, që e vërtetojnë këtë, trashëgiminë kulturore, përpjekjet për ruajtjen e identitetit kombëtar qysh nga Lidhja e Prizrenit, Kuvendi i Prevezës, e deri te dhëlpëritë e qeverive greke për t’i deportuar çamët nga trojet e tyre, pra, për të realizuar spastrimin etnik



të atyre trevave. Po ashtu, ai ndalet gjatë te përshkrimi i krimeve që u bënë ndaj asaj popullsie, duke gjetur pretekste sa absurde aq keqdashëse, krime që për nga mizoritë e barbaritë nuk do të shlyhen lehtë nga kujtesa popullore. Se nuk mund të harrohet asgjësimi i 600 burrave në 27 qershor të vitit 1944 në kishën e Paramithisë, të prerë në besë nga përbindëshi Napoleon Zerva. Prof. Selmani hedh poshtë me fakte dhe shifra të ashtuquajturin bashkëpunim të çamëve me gjermanët, po ashtu ai shpjegon sesi u veprua edhe nga regjimi komunist me heqjen e shtetësisë greke, çamëve të përzënë dhe trajtimin me dyshime të pandara ndaj tyre nga qeveria, por kurrësi jo nga populli i cili u soll me ta si me vëllezërit e të njëjtit gjak. Në libër gjejmë të zbardhura disa intervista televizive po nga ky autor me cilësinë e Kryetarit të shoqatës “Çamëria”.

Selman Sheme në këtë rol, ka folur burrërisht dhe pa ju dridhur qerpiku kudo që ka mundur për të sensibilizuar opinionin rreth domosdoshmërisë së zgjidhjes së problemit çam dhe abrogimit të ligjit qesharak të luftës me Shqipërinë që Greqia mban qëllimisht në fuqi. Ai gjithashtu tregon edhe rrugët sesi duhet bërë realizimi i të drejtave të çamëve, të cilat konsistojnë: në riadhesimin e tyre në vatrat prej nga u shpërngulën forcërisht, kthimi fizik i pronave sipas nenit 2 të Konventës të të Drejtave të Njeriut dhe kompensimi për shfrytëzim i objekteve për më shumë se 60 vjet. Ky autor ka edhe një shqetësim tjetër mjaft të rëndësishëm; rrënimin e qendrave kryesore urbane si ato të vendit të tij të origjinës Filatit, po ashtu Margëlliçit, Paramithisë, Prevezës, Artës, etj. ku janë gdhendur ato monumente që bënin prezente kulturën autentike çame. Ai nuk e fsheh revoltën e tij kur sheh se Akademia e Shkencave të Athinës në librin e botuar “4000 - vjet histori dhe kulturë helene”, falsifikon të vërtetat historike të Çamërisë, dhe këtu asnjë nga institucionet tona nuk reagon.

Ai shkon më tej duke u shprehur: “Qeveritë shqiptare kurrë nuk kanë shtruar në bisedime ayrtare dypalëshe problemim e njohjes së minoritetit shqiptar në Greqi. Kjo e ka bërë më të lehtë mohimin dhe mosnjohjen e këtij minoriteti nga pala greke”. Dhe vazhdon: “Sot në Çamëri jeton një popullsi shqiptare prej 300.000 banorë të besimit të krishterë. Kjo popullsi i është nënshtruar asimilimit nëpërmjet administratës, shkollës dhe kishës. Është tragjike për minoritetin çam në Greqi që Shqipëria, shteti amë nuk arrin të ngrihet në nivelin e Maqedonisë së Veriut, në përpjekjet për njohjen e statusit të minoritetit çam në Greqi dhe realizimin e të drejtave të tyre”. E sheh këtë si një anë të rëndësishme të çështjes çame që ai me të drejtë e quan “një problem i madh politik, juridik, ekonomik, dhe kulturor albanologjik”. Dhe këtë mesazh prof. Selman Sheme, nuk ia dërgon vetëm politikanëve tanë të pandjeshëm ndaj kësaj çështje, por edhe atyre diplomatëve të Evropës plakë, siç e quan Antoni Baldacci, që këtë tetor pati 156 vjetorin e lindjes, i cili vijon te vepra e tij “Shqipëria e madhe”: “Ky shtyp (i asaj kohe), vuri në qarkullim epigramin e mësuesit që pyet nxënësin se cilët janë kufijtë e Shqipërisë, ku nxënësi u përgjigj se do të pyeste Fuqitë e mëdha”. Ja që fati ynë historik ka bërë që ende po ata, me ndërhyrjet për hir të interesave të tyre, po duan të vendosin mbi tërësinë e stërlashtë të trojeve tona. Në këtë këndvështrim, vepra e prof. Selmanit është mesazh edhe për popullin e sidomos për klasën e përgjumur të intelektualëve që të bashkohemi në të njëjtin kor që i këndon qartazi të drejtave tona të patjetërsueshme kombëtare, të lëna trashëgim nga stërgjyshët tanë.

DY VEPRIMTARI NË NJË DITË- Art dhe letërsi bashkë

(Vijon nga faqja 14)

dim të ngjeshur e përgjithësues historik, psikologjik dhe filozofik. Shprehje, që duhen futur në kujtesë, për t’u përdorur në fjalime, në takime, në biseda në odat e burrave, pse jo edhe për ilustrim shkrimesh.

Po rendis disa. Gjykoni vetë për forcën dhe përmbajtjen e tyre:

- Marrim përsëri mendimin e kohës, për kohën: qëllimi qëndron te realiteti: etja për të vërtetën krijon rrjedhojën për të shtjelluar ato çfarë ndodhën.
- Gjithnjë duhet të flasë njeriu me mendimin, pastaj vjen shkrimi. Shkrimi duhet të jetë i saktë për të dhënë atë çfarë ka ekzistuar, ndodhur, por kurrë atë çfarë ndokush aludon, fantazon apo trillon.
- Heshtja, ky element bazë i jetës sime, më ka dhuruar të domosdoshmen, “shpëtimin e qenies”.
- Historia e qytetit ishte shume më e vjetër se liria e tij.
- Shkodra ime, qytet i vuajtur, me lotët e saj bashkonte njerëzit pa asnjë dallim feje apo ideje.

- Mbijetesja e qytetit tim është një mrekulli e vërtetë.....
 - Durimi është cilësi që të jep mundësinë e arritjes, por kur shpërthen, nuk dihet se çfarë ndodh.
 - Duhet të njohësh çelësin e së drejtës, për të parë (vlerësuar) më mirë të vërtetën, në qoftë se ti do të arrish të krijosh.
 - Burim i ndjenjës është baza (bërthama), që krijon mundësinë, lirinë shpirtërore, art, finalizim i pasqyrë e së vërtetës, me përqaftimin e së drejtës.
 - Krijimi për momentin nuk e percepton kahen, por instikti i ndjenjës i jep vrull, guxim, kap thelbin e saj për t’u ngjitur lart.... Vrullin për të evoluar vazhdimin, frymën, ndjenjën shpirtërore, përparësinë për të arritur..... etj, etj.
- Urime i nderuar Mark! Ke sjellë një libër të rrallë për nga forma, por të ngjeshur në mendime, vuajtje, përjetime dhe zhgënjime!
- Sikur ta kishe kripur me pak humor shkodran, libri do të ishte edhe më i bukur. Do na bënte të qeshim përsëri!
- Suksese në udhën e ndritur të krijimtarisë letrare dhe artistike!

SPECIALE - EVENIMENT

OBVL, SESION SHKENCOR PËR ÇETËN PARTIZANE TË GOLLOBORDËS

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ (OBVL), në bashkëpunim me bashkitë e Dibrës dhe Bulqizës, organizoi më 7 tetor 2023 sesionin shkencor me temë: “Çeta antifashiste dhe partizane e Gollobordës me komandant Ahmet Fetah Camin”.

Pas ekzekutimit të himnit kombëtar, qindra pjesëmarrësit që kishin mbushur sallën e madhe të Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë, ndoqën me vëmendje dhe interes të veçantë filmin dokumentar kushtuar Çetës partizane të Gollobordës dhe veprimtarisë atdhetare të dëshmorit Ahmet Fetah Cami - pjesëmarrës i dy Luftrave Botërore dhe komandant i kësaj çete, me skenar dhe regji të Tefta Camit - ish ministere e Arsimit dhe Kulturës.


Në këtë sesion shkencor të moderuar me kompetencë shkencore nga Prof.dr.Paskal Milo, u mbajtën katër kumtesat si vijon:

- Ahmet Cami-biografi e shkruar me gjak si pjesëmarrës i dy luftave botërore - nga Halil Rama-Mjeshtër i Madh;
- Krijimi i Çetës Antifashiste të Gollobordës në janar të vitit 1940 dhe kthimi në Çetë parti-

zane nga komandanti Ahmet Cami në maj të vitit 1943 - nga historiani, Dr. Kadri Dauti;

- Dukuri luftarake për Çetën partizane të Gollobordës - nga Prof. asoc. dr. Bernard Zotaj;
- 80-vjetori: Lufta për mbrojtjen e qytetit të Peshkopisë në vitin 1943- nga Dr .Asllan Zemani.
- Lufta e çetave partizane të Batalionit të Dibrës dhe të Çetës partizane të Gollobordës për çlirim-in e viseve shqiptare përtej kufirit dhe të qytetit të Dibrës së Madhe në vitet 1943-1944 kundër forcave pushtuese nazifashiste - Nga Prof.dr.Nebi Dervishi (publikuar në sesion, pa praninë e tij, për arsye familjare).

Kryesia e OBVL falenderon të gjithë pjesëmarrësit nga Shqipëria e Kosova që na nderuan me praninë e tyre.




• Shqipëria është kaq e vogël se të tillë na dëshën pushtuesit, por mbijetesa e kombit tonë qëndron tek gjaku dhe sakrificat e mbi të gjithë tek e ardhmja që gargantuan bijtë e Dibrës dhe gjithë Shqipërisë në luftën e lavdishme të formacioneve nacionalçlirimtare



AHMET CAMI - PJESEMARRËS I DY LUFTRAVE BOTERORE E puthi vdekjen me këngën e lirisë në gojë - “Ja dy pëlëmbë e mbi shokë, ja i katërbëdhjetë dhe nën tokë”:

- 1- Puna ime le të jetë lufta dhe pagja ime të jetë fitorja.
 - 2-Epo kështu është kjo botë... Herë ulet e herë ngrihet.
 - 3-Parajsa e kësaj bote është grueja e mirë.
 - 4- Ma sa bëhet mushkeria jani aq bëhet kopuku zotëri. I keqi më mirë të mos jete. Po për çudi ata gjithmonë jetojnë më gjatë për sehir të dynjase.
 - 5-Ja dy pëlëmbë e mbi shokë , ja i katërbëdhjetë dhe nën tokë.
 - 6-Interesi të daltë fundi, nuk na le mik kurkundi.
 - 7-Kur të të gjejë ditën, të nxjerr dritën.
 - 8- Këta njerëz që të ulën sot do t'ju ngrajnë sërish nesër.
 - 9-Mos besoni kerkend përveç të vërtetës. Omar Kayam ka thene ; E vërteta është “nji” dhe Ai njëshi je ti vetë.
 - 10-Njeriu përpara ligjit është si vesa para diellit. Sikur të isha person juridik dhe sidomos nëse do të kisha detyrën e Prokurorit të Shtetit ndaj këtyre njerëzve, që tentojnë me prishur dhe shkatërrue krejt jetën shoqërore, kisha me u tregue tepër i rreptë dhe pa pikë shpirti e ndërjegjeje, duke gjetur dispozitat më të rrepta që flasin për këto qëllime.
 - 11- Napoleon Bonaparti ka thënë; “Në prehnin e nanës ndahen fatet e kombeve.”Pra ku mbeti vlerësimi i femrave shqiptare?!
 - 12-Mirë ka thënë Fishta; “Zani i zi për Shqipëri. ”Po si nuk foli kush mirë për ne shqiptarët!!!
- Sentencat e mesiperme jane marr nga ditari qe ka shkruar në burg Ahmet Cami si antifashist në vitet 1941-1942.



“Ne partizanët e Batalionit Partizan të Dibrës e çliruem Dibrën e Madhe e shumë fshatra e qytete. Ju keni premtuar, se me çlirimin e vendit viset shqiptare do t'i bashkohen Shqipërisë. Dhe po u hoq flamuri shqiptar, e gjithë Dibra është e rrethuar...”